

URAT E MULTIKULTURALIZMIT PËRMES EDUKIMIT MUZEOR

doracak për
mësimdhënie

URAT E MULTIKULT PËRMES

Botuesi:

Qendra për Arsimim
Qytetar (QAQ)

Redaktore:

Daliborka Ulareviq

Autori:

Filip Kuzman

**Përktheu në
gjuhën shqipe:**

Monika Mrnjaçeviq



Ministarstvo ljudskih
i manjinskih prava

Publikimi "Urat e Multikulturalizmit përmes Edukimit Muzeor – Doracak për mësimdhënie" është krijuar në kuadër të projektit "Urat e Multikulturalizmit përmes Edukimit Muzeor" i cili zbatohet nga Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ) me mbështetjen e Ministrisë të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave.

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe e QAQ-së.

Fotot për doracakun janë siguruar nga Muzeu Kombëtar i Malit të Zi.

URALIZMIT S EDUKIMIT MUZEOR

doracak për
mësimdhënie

Podgoricë, 2024.

• PËRMBAJTJA

Hyrje	5
Metodologjia	7
Muzeu Kombëtar i Malit të Zi	9
• Veshjet popullore e Malit të Zi	11
• Piktura	22
• Arti sakral	28
• Traditat e varrimit	33
• Gjurmët e shkruara në Mal të Zi	38
• Instrumentet muzikore	41
• Tregtia	45
• Multikulturalizmi në antikit	48
• Multikulturalizmi i Principatës së Malit të Zi	51
• Lëvizja Nacional-Çlirimtare	58
Struktura e mësimdhënies	63
Literatura	69

01 Hyrje

Ky doracak mund të përdoret në shkollat fillore dhe të mesme, pra nuk është krijuar vetëm për mësues/se të historisë dhe historisë së fesë, por edhe për mësues/se të arteve figurative/kulturës, arteve muzikore/kulturës, sociologjisë (të përgjithshme dhe të kulturës)... Secila nga këto lëndë mësimore ka synime të përcaktuara dhe besojmë se doracaku mund t'i ndihmojë në përmbushjen e disa prej tyre.¹

Lënda mësimore *Historia* synon, ndër të tjera, që nxënësi të kuptojë se çka është trashëgimia e shoqërive të kaluara që është aktuale edhe sot; mëson më gjërësisht për studimin e kulturave të tjera, mendimeve të ndryshme dhe paraqitjen e argumenteve dhe për ta motivuar të studiojë historinë kombëtare dhe ta orientojë në kultivimin e formave demokratike të sjelljes, tolerancës fetare dhe kombëtare.² Me ndihmën e këtij doracaku, mësuesi/sja i/e historisë do të jetë në gjendje që përmes shembullit të Muzeut Kombëtar të Malit të Zi të shpjegojë se cila trashëgimi është aktuale sot dhe për ta bërë më të lehtë për nxënësit mësimin për kulturat e tjera. Me këtë lidhet edhe lënda zgjedhëse *Historia e Fesë*, e cila synon gjithashtu ndërgjegjësimin për kulturat dhe traditat e ndryshme.³

Duke e pas parasyshë se dy tema në këtë doracak i kushtohen artit, lidhja me lëndën *Arti figurativ* është e natyrshme. Pra, qellimet që mund të realizojnë duke përdorur këtë publikim janë *prezantimi i artit kombëtar me theks në monumentet dhe veprat nga mjedisi më i afërt; kuptimi i artit dhe kulturës së vet dhe vlerësimi i artit dhe kulturës në trashëgiminë kulturore të Evropës dhe ndërtimi i kulturës së dialogut dhe kritikës tolerante*⁴. Për më tepër, një nga

¹ Në këtë pjesë do të nënvizojmë qëllimet vetëm për lëndët që mësohen në shkollën e mesme të përgjithshme. Kjo nuk do të thotë se ky Doracak nuk mund të përdoret në shkollat fillore dhe të tjera të mesme.

² N. Perosheviq, J. Gjorgjeviq, V. Kovaçeviq, *Programi lëndor Historia I, II, III dhe IV klasë*, Podgoricë 2020, fq. 4.

³ J. Gjorgjeviq, R. Popoviq, D. Gjokiq, *Programi zgjedhor Historia e fesë 1 dhe programi zgjedhor Historia e fesë 2*, Podgoricë 2009, fq. 3.

⁴ D. Berilazhiq, V. Shqepanoviq, S. Boriçiq, *Programi zgjedhor Arti figurativ*, Podgoricë 2020, fq. 4.

qëllimet e lëndës *Arti Muzikor* është zhvillimi i *mirëkuptimit dhe respektit ndërkulturor përmes mësimit të muzikës dhe traditave muzikore të kulturave të ndryshme*, dhe mund të përmbushet përmes temës *instrumentet muzikore*.⁵

Doracak mund të përdoret gjerësisht në lëndët *Sociologjia e Përgjithshme* dhe *Sociologjia e Kulturës*, duke qenë se të dyja lëndët synojnë të zhvillojnë tolerancën, empatinë, komunikimin, kuptimin e kulturës tjetër, si dhe luftën kundër paragjykimeve, stereotipeve, ksenofobisë, ekskluzivitetit, etnonacionalizimit...⁶

Ky doracak u krijua me qëllim që t'u ofrojë mësuesve ide të reja për të ndërtuar urat e multikulturalizmit. Besojmë se materiali i përzgjedhur mund të ndihmojë stafin mësimdhënës në shtypjen e stereotipeve dhe paragjykimeve të nxënësit/et dhe zhvillimin e ndjenjës së tolerancës dhe mirëkuptimit ndaj "të tjerëve".

⁵ T. Krkeliq, T. Janković, B. Nikezić, *Programi zgjedhor Arti muzikor*, Podgoricë 2020, fq. 4.

⁶ N. Krivokapiq, A. Ivanović, I. Gjukiq, *Programi lëndor Sociologjia për klasën e III të shkollës së mesme të përgjithshme*, Podgoricë 2020, fq. 4-5; N. Krivokapiq, A. Ivanović, I. Gjukiq, *Sociologjia e kulturës për klasën e III të shkollës së mesme të përgjithshme*, Podgoricë 2020, fq. 4 dhe N. Krivokapiq, A. Ivanović, I. Gjukiq, *Sociologjia e kulturës për klasën e katërt të shkollës së mesme të përgjithshme*, Podgoricë 2020, fq. 4.

02 Metodologjia

Pozita e Malit të Zi dhe zhvillimi i tij historik bëri që në territorin e tij të takohen civilizime të ndryshme: ilire, greke, romake, bizantine, sllave, veneciane, osmane dhe të evropës moderne.⁷ Nga ky bashkim lindi multikulturalizmi që sot karakterizon shoqërinë malazeze. Multikulturalizmi nënkupton kultura të ndryshme brenda një shoqërie ose komuniteti, të cilat janë të pranuar dhe me dallimet e të cilave njerëzit jetojnë së bashku. Në një shoqëri të tillë, çdo individ ka të drejtë të ruajë dhe eksplorojë kulturën e tij. Nga multikulturalizmi vjen ndërkulturalizmi, i cili i referohet mirëkuptimit të ndërsjellë, ndërveprimit dhe dialogut ndërmjet kulturave të ndryshme, me qëllim tejkalimin e paragjyimeve, stereotipeve të ndryshme dhe parandalimin e konfliktit ndërmjet grupeve të ndryshme.

Është pikërisht roli kyç i sistemit arsimor në zhvillimin e arsimit dhe edukimit ndërkulturor të nxënësve që nga mosha më e hershme dhe është përgjegjësi e stafit mësimdhënës që t'u mundësojë të rinjve të tejkalojnë konfliktet dhe të ushqejnë tolerancën.⁸ *Ligji i Përgjithshëm për Arsim dhe Edukim* e njeh multikulturalizmin e Malit të Zi duke rregulluar të drejtat e pakicave në këtë fushë.⁹

Udhëzimet e UNESCO-s për Arsimin Ndërkulturor, nga viti 2006, dhe Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Mësimdhënien cilësore të Historisë në shekullin XXI, nga viti 2018, ofrojnë gjithashtu një kornizë ndërkombëtare për mënyrën se si duhet të zbatohet ky lloj edukimi. Udhëzimet e UNESCO-s rekomandojnë që çdo nxënësi/se t'i sigurohet edukimi i duhur kulturor, pra t'i sigurohen njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme kulturore për të qenë qytetarë/re aktivë dhe të përgjegjshëm, si dhe t'i sigurohen njohuri, aftësi dhe qëndrime kulturore që u mundëson atyre të kontribuojnë në respektin, mirëkuptimin dhe solidaritetin midis individëve/eve, grupeve etnike, sociale dhe kulturore dhe kombeve.¹⁰ Këshilli i Evropës konsideron se mësuesit/set (kryesisht të historisë) duhen të pranojnë ekzistencën e njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore, fetare dhe etnike dhe të respektojnë identitete të ndryshme. Historia e njerëzimit është historia e ndërkulturalizmit, ku kulturat komunikuan kur komunitete të ndryshme vinin në kontakt, theksojnë në Udhëzime.¹¹

⁷ R. Vujović, M. Vukanović, *Pasuria e diversitetit*, Podgoricë 2021, fq. 5.

⁸ V. Radulović, *Multikulturalizmi dhe komunitetet e nënpërfaqësuar në sistemin arsimor malazez*, Podgoricë 2023, fq. 14-15.

⁹ *Ligji i Përgjithshëm për Edukim dhe Arsimin*, <https://www.gov.me/dokumenta/a5f6b50c-2d6f-475d-8d65-1e124d10b33e> (aksesuar me 19. 03. 2024).

¹⁰ V. Radulović, *Multikulturalizmi dhe komunitetet e nënpërfaqësuar në sistemin arsimor malazez*, Podgoricë 2023, fq. 8-9.

¹¹ *Quality History Education in the 21st Century – Principles and Guidelines*, Council of Europe, September 2018. <https://edoc.coe.int/en/teaching-history/7754-quality-history-education-in-the-21st-century-principles-and-guidelines.html> (aksesuar me 19. 03. 2024).

Sipas Kodit të Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve (ICOM), muzeu është i detyruar të jetë në shërbim të shoqërisë dhe përparimit të saj. Si rregull, muzeu është i hapur për publikun dhe duhet të përdorë çdo mundësi për të zhvilluar rolin e vet si burim të arsimit. Është detyrë e tij të interesojë të gjitha shtresat e shoqërisë dhe t'u mundësojë të gjithë individëve dhe grupeve të përfshihen në aktivitetet e muzeut.¹²

*Ligji për Veprimtarinë e Muzeut e detyron muzeun t'i sigurojë të gjithëve (si individualisht apo kolektivisht) akses në koleksionin muzeor, objektet e muzeut dhe dokumentacionin e muzeut.*¹³ Në të njëjtën kohë, si institucion kulturor, sipas Ligjit për kulturë, muzeu është i obliguar të ruajë veçoritë origjinale dhe tradicionale kulturore dhe etnokulturore.¹⁴ Nga të gjitha më sipër, rezulton se muzetë kanë potencialin për të qenë një ndihmë e madhe për arsimin, ndaj edhe ky manual synon të jetë një lidhje midis muzeut dhe klasës.

Muzeu Kombëtar i Malit të Zi, mbase trashëgon një numër të madh objektesh muzeale që dëshmojnë për multikulturalizmin në territorin e Malit të Zi gjatë gjithë epokave, mund të luajë një rol të rëndësishëm në edukimin ndërkulturor. Objektet janë të shumëllojshëm, nga monedha të vogla dhe bizhuteri, deri te kostumet kombëtare të dekoruara. Ky doracak përmban një përzgjedhje materialesh të grupuara në 10 njësi tematike: antikiteti, varrimi, shkrim-leximi, arti sakral, piktura, instrumentet muzikore, veshjet popullore, tregtia, Principata e Malit të Zi dhe Lufta Nacional Çlirimtare.

¹² A. Miranoviq, P. Malbasha, A. Berkuljan, *Manual - përmbledhja e rregulloreve bazë dhe të lidhura me aktivitetet e muzeut, arkivit dhe bibliotekës*, Cetinë 2019, sfq. 9.

¹³ të Ligjit për Veprimtarinë Muzeale, neni 23, <https://www.gov.me/dokumenta/892a425d-1791-480a-8c71-3b915d57b9a4>, (aksesuar me 21. 03. 2024).

¹⁴ Ligji për kulturën, neni 5, pika 10, <https://www.gov.me/dokumenta/a68a12da-1e34-4cf3-9aab-5a8d1f04b19f> (aksesuar me 21. 03. 2024).

03 Muzeu Kombëtar i Malit të Zi

Historia

Rrënjët e veprimtarisë muzeale në Mal të Zi mund të gjurmohen deri në kohën e peshkopit Pjetri II. Ai është sundimtari i parë i dinastisë Petroviq-Njegosh, i cili filloi seriozisht të mbledhë materiale dhe objekte arkivore (kryesisht armë trofe). Koleksionet e mbledhura i vendosi në Bilardo (Biljarda), madje *Gazeta serbe* në prill të vitit 1840 shkruante për materialin mbresëlënës që mbledhi Njegoshi.

Në vitin 1870 koleksionet e para, Princ Nikolla i zhvendosi në Laboratori, në ndërtesën e re që shërbente si punishte ushtarake. Është gjithashtu muzeu i parë në kuptimin e plotë të fjalës. Nga natyra, Laboratori ishte një muze ushtarak, sepse aty ishin të ekspozuara armët e kapura në luftërat me osmanët.¹⁵

Gjatë kremtimit të katër shekujve të shtypshkronjës Obod në vitin 1893, lindi ideja e krijimit të një Muzeu Shtetëror. Tre vite kaluan në rregullimin e materialit, që më 6 dhjetor 1896, Princ Nikolla shpalli Ligjin e Principatës malazeze për Bibliotekën dhe Muzeun. Sipas ligjit, Biblioteka Shtetërore dhe Muzeu ndodhen në ambientet e Shtëpisë Zeta dhe janë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit dhe Çështjeve të Kishës. Neni 8 parashikon që Muzeu mbledh të gjitha antikitetet që janë gjetur dhe gjenden në Mal të Zi, si dhe të gjitha gjërat e rëndësishme nga vendet e tjera. Muzeu ka qenë i vendosur në Shtëpinë e Zetës deri në pushtimin e Malit të Zi në Luftën e Parë Botërore, kur ka pushuar së punuari.¹⁶

Puna e muzeut nisi përsëri në vitin 1926, këtë herë në ish-kështjellën e mbretit Nikolla. Falë përkushtimit të punëtorëve, në radhë të parë Dushan Vuksanit, Millosh Medenicës dhe Risto Dragiqeviqit, një pjesë e madhe e fondit u shpëtua nga degradimi, veçanërisht gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në ato vite të vështira muzeu funksionoi, por nën presionin e madh të pushuesve.

Pas çlirimit, autoritetet komuniste filluan të ngrinin muze të reja në Cetinë. Fillimisht në vitin 1950 u

¹⁵ J. Muhadinoviç, *Muzeu i Cetinës*, u: F. Kuzman, *Hëna nën Lovqen*, Cetinë 2023, fq. 9-10.

¹⁶ Gj. Batriqeviq, *Zhvillimi i shërbimit muzeor në Mal të Zi*, Cetinë 1998, fq. 53-54.

themelua Muzeu i Luftës Nacional-Çlirimtare (LNÇ) dhe Galeria e Arteve e Malit të Zi (pararendës i Muzeut të Artit) dhe vitin e ardhshëm Muzeu i Njegoshit (në Bilardo) dhe Muzeu Etnografik. Pak më shumë se një dekadë më vonë, në vitin 1963, të gjitha njësitë muzeale u inkorporuan në një institucion të quajtur Muzetë e Cetinës.¹⁷

Por, gjatë vitit 1967, pati një ndryshim në organizim. Muzeu LNÇ u mbyll dhe materiali i tij u trashëgua nga Muzeu Historik i sapothemeluar.¹⁸ Pasi një punë shumëvjeçare në Ekspozitën e përhershme, e cila u përfundua në vitin 1989. Kështu, Mali i Zi fitoi një ekspozitë muzeale që mbulonte periudhën nga parahistoria deri në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Gjatë viteve 1990, emri u ndryshua nga Muzetë e Cetinës në Muzeu Kombëtar i Malit të Zi (MKMZ), i cili përdoret edhe sot.¹⁹ Ndryshimi i fundit organizativo-muzeal i MKMZ-së ishte në vitin 2011, kur në kuadër të tij u themelua Muzeu Arkeologjik i Malit të Zi. Në vitin 2016, Muzeu Historik e riorganizoi ekspozitën në periudhën pas vitit 1918, për të përfshirë ngjarjet e pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 2006, ndërsa në vitin 2018, Muzeu Etnografik fitoi një ekspozitë të re të përhershme.

Organizimi

Sipas statutit, Muzeu Kombëtar i Malit të Zi është muze publik i një lloji kompleks, me detyrë që të merret me historinë, etnografinë, artin dhe arkeologjinë e Malit të Zi. Këtu përfshihet grumbullimi i materialit muzeor, zbatimi i mbrojtjes parandaluese dhe të përhershme, përpunimi profesional i materialit, ruajtja e përkohshme e materialit muzeor që nuk i është siguruar mbrojtja adekuate muzeale në një institucion tjetër, dhënia e mendimit eksperte, kryerja amë e veprimtarisë muzeale në lidhje me muze të tjera në Mal të Zi etj. Përveç muzeut, institucioni merret edhe me veprimtari bibliotekare dhe arkivore (Departamenti i Bibliotekës dhe Arkivave), si dhe me mbrojtjen parandaluese (Departamenti për Mbrojtje Parandaluese dhe të Përhershme).

¹⁷ J. Muhadinoviq, *Muzetë e Cetinës*, u: F. Kuzman, *Hëna nën Lovqen*, Cetinje 2023, fq. 13-14.

¹⁸ Gj. Batriqeviq, *Zhvillimi i shërbimit muzeor në Mal të Zi*, Cetinë 1998, fq. 100.

¹⁹ J. Muhadinoviq, *Muzetë e Cetinës*, u: F. Kuzman, *Hëna nën Lovqen*, Cetinë 2023, fq. 14.

**Ndryshimi
i fundit
organizativ
dhe muzeal
në Muzeun
Kombëtar
të Malit të Zi
ndodhi në
vitin 2011, kur
brenda tij
u themelua
Muzeu
Arkeologjik i
Malit të Zi.**

Muzeu është projektuar të përbëhet nga katër muze:

1. Muzeu Historik

- Instalimi përhershëm në Shtëpinë e Qeverisë,
- Muzeu i Njegoshit (Bilardo dhe vendlindja e Njegoshit në Njegushe),
- Muzeu i Mbretit Nikolla,
- Mauzoleumi i Princ Danillos në Orlov Krsh
- Mauzoleumi i Pjetrit II Petroviq - Njegosh në Lovqen,
- Mauzoleumi i sundimtarëve malazezë - Kisha Mbretërore në Qipur

2. Muzeu Arkeologjik

3. Muzeu Etnografik

4. Muzeu i Artit

- Instalimi përhershëm në Shtëpinë e Qeverisë,
- Galeria e Artit malazeze “Miodrag Dado Gjuriq”²⁰

Një muze i konceptuar në këtë mënyrë ka në fondin e tij dhjetëra e dhjetëra mijëra objekte muzeale, të cilat flasin për aspekte të ndryshme të zhvillimit kulturor dhe historik të Malit të Zi. Për shkak të sasisë së madhe të materialit, si dhe për faktin se Muzeu Kombëtar i Malit të Zi është institucioni muzeologjik kryesorë në shtet, me synimin për të trashëguar trashëgiminë kulturore të të gjithë qytetarëve të Malit të Zi, ky *Doracak* do të trajtojë vetëm materialet që gjenden në këtë muze, pra ka ende vend që muzetë e tjerë në Mal të Zi do të trajtohen me një doracak të ngjashëm në të ardhmen.

Veshjet e Malit të Zi

Muzeu Etnografik ka një koleksion shumë të pasur veshjesh nga i gjithë Mali i Zi, të cilat zënë një pjesë të madhe të ekspozitës së përhershme dhe janë pjesa më tërheqëse e këtij muzeu. Në to janë ruajtur gjurmë të trashëgimisë së vjetër ballkanike, greke, romake, bizantine dhe sllave, si dhe elemente të kulturës mesdhetare dhe orientale.²¹ Ndikimi më i madh vjen nga venedikasit dhe osmanët, dy fuqi të mëdha që sunduan këto zona për disa shekuj.

Veshjet kombëtare të Malit të Zi janë dëshmues të çmuar të aspekteve të ndryshme të jetës kombëtare dhe zbulojnë tablonë e klimës, të kushteve natyrore dhe klimatike, si dhe të zonave ekonomike të veprimtarisë në të cilat janë krijuar.²² Në nivel individual, ato zbulojnë përkatësinë etnike dhe fetare. Multikulturalizmi i Malit të Zi pasqyrohet më së miri përmes kostumeve, sepse ka shumë stile të ndryshme veshjesh në një hapësirë të vogël.

²⁰ Statuti i Institucionit Publik Muzeu Kombëtar i Malit të Zi, Cetinë 2019. Veprimtaritë e Muzeut Kombëtar të Malit të Zi rrjedhin nga Ligji për Veprimtarinë Muzeale, <https://www.gov.me/dokumenta/892a425d-1791-480a-8c71-3b915d57b9a4>, (aksesuar me 19. 03. 2024. u 20:37h).

²¹ T. Rajković, *Bukuria e diversitetit*, Cetinë 2023, fq. 2.

²² L. Gjuriq, T. Rajković, B. Markush, *Veshjet kombëtare të Malit të Zi të shekullit XIX - XX*, Cetinë 2018, fq. 10-11.



Veshja ceremoniale malazeze për burra



foto: Veshja
ceremoniale
malazez për
burra

Kjo veshje karakterizohet nga shtresëzimi dhe një numër i madh veshjesh.

Përbëhet nga një kapelë, këmishë, xhamadan, pantallona (dimija), gunja, jelek, rrip lëkure, mantel, petkë, çorape poshtë gjurit, geta dhe opinga. Kapela është e cekët, e rrum-bullakët, e përbërë nga një brez i zi me një kurorë të kuqe. Në sipërfaqen e kurorës ishin qëndisur detaje të ndryshme (stema, iniciale, yll gjashtëcepësh...). Këmisha ishte e përbërë prej liri ose pëlhurë pambuku, mbi të cilën vishej një xhamadan me ose pa mëngë prej petkës të kuqe. Pantallonat janë prej petkës blu, me gjatësi deri nën gju. Mbi xhamadan vishej një gunja, zakonisht jeshile e çelur, e gjatë deri tek gjuri, me mëngë të ngushta të gjata dhe me pjesën e përparme që nuk mbyllet. Jeleku është pa mëngë, i cili nuk mbyllet për të treguar dekorimet në xhamadan. Dushanka (manteli) veshet mbi gunja dhe është e qepur nga stof i kuq, me pjesë të përparme që nuk mbyllet dhe mëngë të gjata që nuk tërhiqen por bien lirshëm. Silavi (rrip lëkure) dhe petka (rrip i gjerë 5-6 metra) lidhen rreth belit. Çorapët poshtë gjurit janë prerë nga një copë shajaku dhe janë mbështjellur rreth kyçeve të këmbës. Në këmbë visheshin geta dhe opinga deri në kyçin e këmbëve të bëra nga lëkura e lopës.²³

²³ Njësoj, fq. 22-30.



Veshja ceremoniale e grave malazeze



foto: Veshja
ceremoniale
e grave
malazeze

Veshjen e grave e karakterizon eleganca dhe thjeshtësia e prerjes.

Është e përbërë nga kapela, këmisha, xhaketa, koreta (mantel), kotula (fund), çorapë, opinga (këpucë) dhe bizhuteri. Mbi kokë vishej kapela prej shajaku të kuq, e cila në skaj ishte e qëndisur me pëlhurë të zezë. Majën e kapelës e zbukuron qëndisja relievore me fije ari, zakonisht në formë ornamentit lulesh. Këmisha është e përbërë prej mëndafshi ose bordur pambuku, e prerë drejt me një të çarë në gjoks dhe mëngë të gjata e të gjera, në skajet e të cilave qepeshin ndonjëherë dantella. Mbi këmishë shkon xhaketa, e qepur nga veluri, zakonisht e kuqe ose bordo. Xhaketa nuk ishte e kopsuar, për tu parë qëndisja e bukur në këmishë. Mbi xhaketë veshet koreta (manteli) nga shakaju i jeshilë të çelur pa mëngë, gjatësia e së cilës arrinte deri posht gjurit. Kotula, pra fundi është prej mëndafshi, me gjatësi deri poshtë gjurit. Çorapet janë të një ngjyre, të thurura me fije pambuku, ndërsa opingat (këpucët) janë të prodhuara në vend dhe të bërë nga lëkura e lopës. Bizhuteria, në veshjen e grave dominon nga çemeri, një rrip argjendi i punuar në teknikën e gërshëtimit dhe filigranit.²⁴

²⁴ Njësoj, fq. 32-38.



Veshja urbane e burrave boshnjak/ mysliman



foto:
Veshja
urbane e
burrave
boshnjak/
mysliman

Veshja karakterizohet nga pasuria e mjeshtërisë që tregon për mundësitë materiale dhe një përkatësi të qartë klasore.

Përbëhet nga fesi (kapela), këmisha, xhamadani, fermen (jelek pa krahë), çakshiri (pantallona), trabolus (rrip mëndafshi), çorape dhe këpucë. Në kokë vishej një fes, nga shajaku i kuq me një xhufkë mëndafshi të zi. Këmisha me mëngë të gjata përbëhej prej pëlhures së bardhë pambuku, pëlhurë liri cinta ose bordur. Mbi këmishë vishej xhamadani deri në bel, i bërë nga shajaku i importuar, zakonisht blu e errët, e kuqe ose jeshile. Fermeni vishej mbi xhamadan dhe ishte i përbërë prej shajaku të kuq ose blu. E gjithë sipërfaqja është e zbukuruar me qëndisje me fije ari. Së bashku me këtë, vishej çakshira, që ishin pantallona të gjera që ngushtoheshin nga gjunjët deri te kyçet e këmbës, më së shpeshti prej shajaku. Trabolusi (rripi) prej mëndafshi shumëngjyrësh, 3 deri në 6 metra i gjatë, lidhej rreth belit, mbi këmishë dhe çakshir. Në këmbë vishnin çorape pambuku ngjyrë të errët dhe sipër tyre mbanin këpucë lëkure të ulëta e të zeza.²⁵

²⁵ Njësoj, fq. 168-170.



**Veshja urbane e grave
boshnjake/muslimane**



foto:
Bošnjačka/
muslimanska
ženska
gradska
nošnja

Veshja ishte e përbërë nga pëlhura të shtrenjta mëndafshi të bardhë.

Përbëhet nga tepeluku (fesi), këmisha, anteri (jelek i gjatë si fustan pa mëngë), dimi, çorape, pantofla dhe bizhuteri. Tepeluku është një lloj fesi i qëndisur me perla dhe ar. Këmisha është prej pëlhure pambuku - byrynxyk, mbi të cilën vishej këmisha e gjatë prej bordure mëndafshi. Rreth prerjes pra dekoltesë dhe në të gjithë sipërfaqen e mëngëve, këmisha është e zbukuruar me dantella të pasura dhe qëndisje ari. Mbi këmishë vishej anteria, lloj fustani pa mëngë, që arrinte deri te gjuri. Bëhej prej shajaku, zakonisht me ngjyrë të kuqe, me qëndisje floriri në sipërfaqe. Dimijet janë të qepura nga brokadë mëndafshi të shtrenjtë, saten ose atlas, të qëndisur me ar. Në këmbë visheshin çorape dhe pantofla të ndryshme prej lëkure, kadife ose sateni, të qëndisura me mëndafsh dhe të zbukuruar me rruaza. Pafte - kopset mbaheshin rreth belit si bizhuteri. Ato janë bërë më së shumti prej argjendi në formën e bajameve, gjetheve, pjatave ose rrathëve.²⁶

²⁶ Njësoj, fq. 164-168.



Veshja e burrave Malësorë



foto: Veshja
e burrave
Malësorë

Veshja përbëhet nga qelesnja, këmisha, jeleku, trombolosa, çakshiria, çorapet, pantofla dhe opinga.

Qeleshe është kapele e rrumbullaktë, e cekët, e bërë nga pëlhura e bardhë e mbushur, e cila mbulon vetëm kurorën e kokës. Pranë trupit vishej këmisha prej pambuku të bardhë, pa jakë dhe mëngë të gjata. Mbi këmishë vishej jeleku, prej shajaku ose kadife, e kuqe e errët ose jeshile, e zbukuruar me motive të qëndisura me kordon të zi. Trombolos mbeshtillej rreth belit, rrip prej mëndafshi me model shumëngjyrësh. Çakshiret janë prej pëlhure të bardhë, me prerje të ngushtë, të zbukuruar shumë me gajtane pëlhure dhe me një të çarë përgjatë këmbës. Në këmbë visheshin çorape të thurura prej leshi, pantofla leshi të zeza të zbukuruara me qëndisje ari dhe opinga prej lëkure viçi.²⁷

²⁷ Njësoj, fq. 123-124.



Veshja e grave Malësore



foto:
Veshja e grave
Malësore

Ky kostum përbëhet nga kapela, këmisha, kraholi, xhubleta, xhoka, kërdhokla, paraniku (perparsja e madhe), këputa, çorape, opanat dhe bizhuteri.

Në kokë vihej kapela e rrumbullakët, prej kadifit dhe e zbukuruar me stoli metalike, zakonisht me monedha. Në trup vishej këmisha me mëngë të gjata dhe jakë, e zbukuruar me qëndisje me fije pambuku të bardhë në zbukurim me lule. Mbi këmishë vishej kraholi me mëngë të gjata prej kadifet, zakonisht i kuq, i zi, ngjyrë blu, vjollcë ose bordo. Xhubleta është pjesa më përfaqësuese e kësaj veshje. Ajo vishej mbi kraholl. Bëhet fjalë për fund, në formë zile, me peshë rreth 15 kg, e punuar nga leshi i thurur në formë pëlhurë në katër liq. Mbi pjesën e sipërme të xhubletës shkonte xhoka, zakonisht prej cohë. Paraniku vishej përpara dhe arrinte deri poshtë gjurit. Është bërë nga materiali i kuq pambuku ose leshi dhe është i thurur me vija të ngushta shumëngjyrëshe. Si rrip vishej kërkodha prej lëkure, i zbukuruar me fije metalike. Këputa dhe çorapet janë prej leshi, dhe opingat nga lëkura e viçit. Në shpatull, si bizhuteri, ishte mbajtur një kuti trekëndore me punime filigrani, në të cilën mbante një mbishkrim - hajmali.²⁸

²⁸ Njësoj, fq. 119-122.



Veshja e burrave Bokel



foto:
Veshja e
burrave Bokel

Veshja e burrave Bokel, sipas traditës popullore, e ka origjinën nga shekulli XVI dhe është sjellë nga Italia ose Spanja në Bokë (Gryka e Kotorrit).

Përbëhet nga qerevica (kapela), këmisha, papion, jeçerma (jelek), koreta (xhaketë), pantallona, qemer (rrip), faculeta (shall), bjeçva (gete) dhe crevli (këpucë). Qerevica është kapele e zezë, e bërë nga mëndafsh i zi ose saten. Mesi i kapeles është zbukuruar me qëndisje me fije ari me një lule të qepur. Në trup vishej një këmishë e bardhë prej liri me mëngë të gjata, e cila kishte jakë të palosur. Nën jakë lidhej papioni. Mbi këmishë vishej jeçerma (jeleku), e cila ishte prej kadifes ngjyrë vjollcë, të kuqe të errët ose blu. Jeçerma është e zbukuruar me fletë ari. Mbi jeçermë shkonte koreti i bërë nga shajaku i zezë ose saten. Pantallonat janë të gjera, me këmbë deri tek gjunjët, prej mëndafshi ose sateni. Mbi jelek dhe pantallona shkonte qemeri - rrip prej kadifes të kuqe me tre ndarje të ndryshme në të cilat futeshin armët. Mbi rrip vihej edhe faculeta - shalli, zakonisht me ngjyrë blu. Në këmbë visheshin getet deri tek gjuri ngjyrë të zezë dhe crevlet - këpucë me fjongo të vogël sipër.²⁹

²⁹ Njësoj, fq. 136-138.



Veshja e grave të Dobrotës



foto: Veshja
e grave të
Dobrotës

Si dhe veshja e Bokës, edhe për këtë veshje tradita popullore thotë se është marrë nga Italia ose Spanja në shekullin e XVI.

Veshja përbëhet nga faculeta (shami), bustin (kanatjere), këmishë, brana (fustan), zhupeta (jelek), kamizhola (xhakëtë), travesa (përparse), bjeçva (çorapë) dhe mulica (këpucë). Faculeta vihej në kokë dhe është një shall katror i bërë prej mëndafshi ose pëlhure të hollë pambuku, me ngjyrë më të errët, me thekë të gjata sateni. Në trup vishej bustin, kanatjerë, e bërë me pëlhurë të bardhë pambuku. Mbi bust vishej këmishë me mëngë të gjata prej damasku, tyl ose sateni, me dantella të dekoruara rreth qafës dhe mëngëve. Mbi këmishë vishej brana, fustan i gjatë dypjesësh pa mëngë, i bërë me porhetë me dizajn lulesh. Mbi fustan shkonte zhupeta, një jelek me gjatësi deri te beli, pjesa e përparme e të cilit ishte prej veluri të kuq dhe pjesa e pasme prej pëlhure të bardhë. Në fund vishej kamizhola, diçka si xhakëtë me mëngë të gjata, prej veluri të kuq. Travesa (përparëse) ishte prej një pëlhurë të hollë ku dominonin ngjyrat e njëtrajtshme ose me motive lulesh. Ajo vishej mbi branë. Në këmbë visheshin bjeçvet (çorape) me fije pambuku të bardhë ose të kuq dhe mulica (këpucë) prej lëkure.³⁰

³⁰ Njësoj, fq. 130-132.



Veshja shajaku të grave Vasojeviq



foto:
Veshja
shajaku
të grave
Vasojeviq

Kjo veshje përbëhet nga kapela dhe namlija (shami), këmishës oblaje, preglaçe (përparse), zubuna (jelek), rripit, alin (xhaketë), çorape, çorape të shkurta dhe opinga.

Në kokë vihej kapela e bardhë prej pëlhures. Mbi kapak vendosej namlija (shami), e cila mbulonte pjesën e sipërme të kokës dhe binte në shpinë. Këmisha oblaja konsiderohej pjesa më e bukur e kostumit. Materiali është nga kërpija ose leshi i hollë me ngjyrë natyrale dhe ndonjëherë është lyer me ngjyrë të kuqe ose të zezë. Gjatësia është deri te kyçi i këmbës me mëngë të gjera, qafë dhe shpatulla të dekoruara. Mbi oblaje vihej një përparëse - preglaçe, e thurur nga uzina (thurur nga leshi në dy fije) e zezë. Është e zbukuruar me theke të gjata të shpërndara përgjatë gjatësisë së skajit të poshtëm dhe anash. Zubuni prej pëlhure të bardhë deri tek gjuri, i prerë pa mëngë, vihej sipër oblajës. Është e zbukuruar me aplikime të ndryshme të çojës të kuqe. Në muajt e dimrit, mbi oblajë dhe zubun vishej një tunikë e trashë pëlhure me mëngë të gjata. Në këmbë viheshin çorape prej leshi shumëngjyrësh deri në gju, pastaj çorapë të shkurta prej leshi shumëngjyrësh të thurur dhe opanak prej lëkure me majë mjaft të theksuara.³¹

³¹ Njësoj, fq. 58-62.



Veshja e grave shqiptare



foto:
Veshja e grave shqiptare

Kjo veshje është karakteristike për rajonin e Plavës.

Përbëhet nga shamia, këmisha, groca (jelek), fundi, futaça (përparse), shpilak (përparse që vihej mbrapa), çorape dhe opinga. Shamija është një shall i kuq prej pëlhure që mbahej në kokë. Në trup vishej këmisha prej pëlhure të bardhë, me ornament lulesh, mbi të cilën vishej jeleku i prerë prej pëlhure të zezë - groca. Në pjesën e poshtme vishej një fund prej pëlhure të bardhë, gjatësia e të cilit ishte deri në gju. Mbi fund lidhej futaça, një lloj përparëseje nga përpara dhe nga mbrapa. Përparësja e përparme është më e madhe dhe me zbukurime shumëngjyrëshe, ndërsa ajo e pasme e njohur si futaça është më e vogël dhe e punuar me pëlhurë të fortë. Në këmbë visheshin çorape të thurura fort prej leshi të zi, mbi të cilat visheshin opanka lëkure.³²

³² Njësoj, fq. 113.

Piktura

Mali i Zi nga mesi i shekullit të XIX, krijoji interesim për artistët, fillimisht rajonal dhe evropian, dhe në fund të shekullit, edhe për artistët e parë vendas. Peizazhet, historia dhe popullsia malazeze ishin një burim i pashtershëm frymëzimi për artistët në vitet në vijim. Pasuria multikulturore u reflektua në faktin se artistë nga të gjitha trevat e vizituan Malin e Zi dhe krijuan veprat e tyre të artit nën ndikimin e saj. Për qëllime të këtij doracak, ne zgjodhëm autorë rajonalë dhe vendorë, anëtarë të kombeve të ndryshme, të cilët u frymëzuan nga temat malazeze dhe veprat e të cilëve gjenden në Muzeun Kombëtar.

Piktura *Koha e shpatave*

Në enterier të errët të përcaktuar nga një mur guri i dalë, një derë në të majtë dhe një dritare e hapur në të djathtë, ka një grup figurash njerëzore. Pjesa qendrore e kompozimit përfaqësohet nga tre figura: në të majtë, një burrë me kapelë të bardhë, i veshur me kostum folklorik - një fund të bardhë dhe bluzë me mëngë të gjera, një jelek të qëndisur me dy kuti metalike për barut të ngjitura në rripin e tij dhe opinga në këmbë. Ai është i ulur në një trekëmbësh prej druri, me shpata në dorën e



foto: *Koha e shpatave*, Pajo Jovanović

majtë të përkulur dhe dorën e djathtë të shtrirë drejt një grupi në të djathtë të përbërë nga një burrë i moshuar i veshur me kostum kombëtar malazez, i vendosur pas një djali zbathur në kostum kombëtar prej pëlhure, dhe mban duart e djalit në të cilën gjenden shpatat. Në sfond, në mur prej guri, është ulur një burrë i moshuar i veshur me kostum kombëtar malazez me puro në dorë dhe një burrë i ri me llullë, i veshur me kostum në pjesën qendrore të kompozimit. Në të majtë të tyre, të fshehura nga figura qendrore e majtë, janë të veshura me kostum kombëtar - një grua me vello, duke mbajtur një fëmijë-bebë në duart dhe një vajzë me dorën e djathtë të ngritur përmbi flokë. Pikturën e mbizotëron tonaliteti i kafe të lehta dhe të errëta me njolla të kuqe në këmbë, kapele të figurave mashkullore dhe rripin e burrit të ulur në trekëmbësh.³³ Vepra është krijuar

³³ Skermë, Inventari i Muzeut të Artit, numri i inventarit 121.

në vitin 1884 nga piktori serb Pajo Jovanović.³⁴ Vepra është punuar me teknikën vaj në pëlhurë, dhe përmasat janë 101 x 151 cm.³⁵

Piktura *Malaziu*

Figura e një burri të veshur me veshjen kombëtare malazeze, me çallmë të kuqe në kokë - e kthyer në profil, është paraqitur me këmbën e djathtë të shtrirë dhe të ngritur në një lartësi të mesme. Në dorën e djathtë, i mbështetur në gju, mban një handjar (thikë), dhe në të majtën një kokë njeriu. Dy pistoletat janë të lidhura rreth belit dhe ndodhet në muret e një qyteti të vjetër. Burri paraqitet nga një sfond i errët i lyer me tone të heshtura kafe të errët në të djathtë dhe të kuqe në të majtë, të cilat përcaktojnë edhe figurën e tij, ku ndriçohen vetëm pjesë të mëngës, fytyrës, pjesë të veshjeve dhe çorapeve. Mbi muret prej guri duket një formë gjysmërrethore bardhë-gri (hëna) që ndriçon skenën.³⁶ Autori i veprës është Gjura Jakshiq³⁷. Ai ka përdorur teknikën vaj në pëlhurë, dhe përmasat e veprës janë 94 x 72 cm. Vepra u krijua në 1875, në kohën e Krizës së Madhe Lindore.³⁸



foto: Malaziu, Gjura Jakshiq

34 Pajo Jovanović (1859-1957) është shkolluar në Vien. Si student, ai udhëtoi nëpër Mal të Zi dhe rajone të tjera të Ballkanit, ku mori frymëzim për veprat e tij të artit. Përveç *Koha e shpatave*, pikturat e njohura me temë malazeze janë: *"Hakmarrja e gjakut nga Kuçi"*, *"Kthimi i çetës së malazezëve nga beteja"*, *"Taverna malazeze"*, *"Lahutari"*, *"Qyteti i rrënuar"*, *"Malaziu i plagosur"* (për të cilin më 1882 mori çmimin e parë të Akademisë dhe një bursë perandorake për arsimimin e studentëve nga Hungaria), studimet e dukës malazez Marko Miljanov dhe Masha Vrbica dhe dr. N. Martinović, Jovanović, Paja, Leksiku i artit të Malit të Zi, CANU 2022, <https://bp.etf.ac.me/leks/web/llucg.php?OID=3444> (aksesuar me 22. 03. 2024).

35 *Koha e shpatave*, Inventari i Muzeut të Artit, numri i inventarit 121.

36 *Malaziu*, Inventari i Muzeut të Artit, numri i inventarit 146.

37 Gjura Jakshiq (1832-1878) është piktor dhe poet serb. Ai u shkollua në Monarkinë e Habsburgëve dhe nga viti 1872 deri në vdekjen e tij jetoi në Beograd. Edhe pse kurrë nuk e vizitoi Malin e Zi, si bashkëkohës përdori imagjinatën e tij për të krijuar skena të heroizmit malazez. Përveç pikturës *Malaziu*, Jakshiq ka pikturuar *Vdekjen Heroike* (nuk është ruajtur, e njohur vetëm nga një riprodhim i gazetës së ilustruar të Beogradit të 16. IX 1866), *Kryengritja e malazezëve*, *Vdekja e Dukës Batriq*, *Bajraktari malazez*, *Beteja e malazezëve me turqit*. N. Martinović, Jakshiq, Gjura, Leksiku i artit të Malit të Zi, CANU 2022, <https://bp.etf.ac.me/leks/web/llucg.php?OID=3429> (aksesuar me 22. 03. 2024).

38 *Malaziu*, Inventari i Muzeut të Artit, numri i inventarit 146.



foto:
Lahutari,
Vlaho
Bukovac

Piktura *Lahutari*

Kompozim i një skene tipike nga jeta malazeze. Në pikturë shfaqen figurat e shtatë burrave, katër grave dhe dy fëmijëve, të veshur me kostume kombëtare shumëngjyrëshe. Rreth lahutarit, të mbledhur e të ndarë në grupe më të vogla, burra e gra malazezë ndjekin këngën me interes të madh. Të gjitha figurat kanë karakteristika të shquara dhe me trup të madh. Entuziazmi dhe hije e lehtë janë të dukshme në fytyrat e tyre. Lahutari i vjetër është ulur mbi një mur guri të ulët, pranë një pirgu të madh bari. Në të djathtë të tij është një figurë e madhe mashkullore, veçanërisht ekspresive për shkak të harmonisë tonale të kostumit. Ulur me këmbë të kryqëzuara, të cilat i mban me dorë, ndërsa pjesa e sipërme e trupit është e sjellur drejt lahutarit. Në të majtë, pranë tij, figura e një djaloshi këmbëzbathur e me flokë të dredhur, me një këmishë ngjyrë të çelur me një hapje të gjerë rreth qafës dhe një shkop në dorën e djathtë. Në plan të parë, në të majtë, janë dy figura interesante mashkullore me flokë gri, me llulla të tymosura e të gjata; ulur në bar me këmbët e përkulura. Në sfond është peizazhi i dallueshëm malor malazez, i ndriçuar nga rrezet e diellit, të cilat depërtojnë përmbi degët e një peme me gjethe. Përhapja e ngjyrës është e thatë dhe e hollë dhe është përdorur teknika vaj në pëlhurë. Përmasat e veprës janë 126 x 200 cm. Piktura është krijuar në vitin 1919³⁹ dhe është vepër e artistit kroat me rrënjë italiane, Vlaho Bukovac.⁴⁰

³⁹ *Lahutar*, Inventari i Muzeut të Artit, numri i inventarit 203.

⁴⁰ Vlaho Bukovac ose Biagio Faggioni (1855–1922), si i ri udhëtoi kontinente dhe dete për të fituar para për shkollimin e tij në Evropë. Ai e sllavizoi emrin e tij duke e ndryshuar Faggioni në Bukovac (faggio – ahu). Ndër veprat e frymëzuara nga Mali i Zi spikasin *Gruaja malazeze në mbrojtje*, *Gruaja malazeze me gyp*, *Gruaja malazeze në takim*, *Portreti i malaziut*, *Malaziu me armë*, *Malaziu i vjetër*, *Biseda e malazezeve*, *Hakmarrja e malazezeve*, *Malazezet pranë pusit*... Ndoshta periudha më e frytshme ishte ardhja e dytë në Mal të Zi (1883), kur gjatë qëndrimit të tij tre mujor pikturoi çiftin në pushtet dhe nëntë fëmijët e tyre. N. Martinović, Bukovac, Vlaho, *Leksiku i Arteve të Malit të Zi*, CANU 2022, <https://bp.etf.ac.me/leks/web/llucg.php?OID=3220> (aksesuar me 22. 03. 2024).

Piktura *Princ Nikolla në kal*

Në sfond neutral, figura mashkullore (Princ Nikolla Petroviq - Njegosh) është paraqitur në pozën e një prijësi, mbi kalin e Kralj Nikollës, Labud (Mjellmë), duke lëvizur në një fushë të gjerë. Ai është i veshur me kostum luksoz malazez, i trajtuar deri në detaje, me dolam, skajet e gëzofit të samurit të së cilës janë të theksuar. E gjithë figura është pikturuar në rrëmbim romantik, si një alegori të Fitimtarit, me tipare të idealizuara të fytyrës dhe një trajtim psikologjik të papërcaktuar. Figura e fortë e kalit të bardhë, nga vrimat e hundës së të cilit shpërthen flakë dhe figura e palëkundur e kalorësit, si të bashkuar, kalërojnë para trimave, duke sfiduar vdekjen. Synimi i autorit për ta portretizuar princin si një udhëheqës malësorësh të patrembur është e dukshme. Në paraqitjen përfaqësuese të personazhit të princit, autori tregoi tendencë më të madhe për të përshkruar efektet e jashtme. Është përdorur teknika vaj në pëlhurë, me përmasa 58.8 x 40 cm.⁴¹ Piktura është krijuar në vitin 1875 dhe autor është Ferdo Kikerec.⁴²



foto:
Princ Nikolla në kal,
Ferdo Kikerec



foto: *Hareme*, Refik Adrović

Piktura *Hareme*

Ky akuaREL është punuar nga disa shtresa të ndryshme ngjyrash transparente, duke krijuar asociacione të peizazhit. Në plan të parë, sipërfaqet trekëndore, ovale dhe me formë të çrregullt krijojnë një asociacion vendbanimesh. Një sipërfaqe e ndriçuar, që fillon nga këndi i poshtëm i majtë dhe rrjedh drejt qendrës, është rrugë apo lumë. Në planin e dytë një sërë njollash jeshile-blu japin pamjen e kodrave dhe plani i fundit është qielli, i cili shkrihet me kodrat në pjesën e poshtme. Hareme janë vendbanime në komunën e Beranës. Përmasat e veprës janë 30 x 40 cm dhe është

⁴¹ *Kralj Nikolla në kal*, Inventari i Muzeut Shtetëror.

⁴² Ferdo Kikerec (1845-1893) piktor kroat. Si përkrahës i afimit kulturor të popujve sllavë, mbërriti në Mal të Zi në vitin 1875, dhe qëndrimin e tij në Cetinë e karakterizoi si "kohën e tij më të lumtur". Kikerec shoqëroi Kralj Nikollën dhe ushtrinë malazeze gjatë konfliktit me osmanët (1875-1876) dhe ishte pjesëmarrës në betejën në Vuçje Dol. Përveç Kralj Nikolla në kalë, temat malazeze gjenden në veprat Vdekja e Dukës Tripko Xhakoviq, Beteja në Vuçje Dol, Beteja e Podgoricës, Malazetët në lëvizje, Qyteti i Kotorrit, Malet malazeze, Cetina me Manastirin, Lahutari malazez.. N. Martinović, Kikerec, Ferdo, Leksiku i Arteve të Malit të Zi, CANU 2022, <https://bp.etf.ac.me/leks/web/lucg.php?OID=3480> (aksesuar me 23. 03. 2024).

krijuar në vitin 1970.⁴³ . Autori i veprës është Refik Adroviq, nënshkrimi i të cilit A. Refik gjendet në këndin e majtë.⁴⁴

Piktura *Kopshti i Vladikës*

Përballë arkitekturës së pazakontë me shtylla, ku ndahet pjesa qendrore gjysmërrethore, është vendosur një figurë femërore me flokë bjonde me shpinë të kthyer dhe në të djathtë është një formë erashkë ngjyrë portokalli të kuqe. Në të majtë është një pedestal ngjyrë verdhë e çilur me karrigë, dhe në të djathtë është një formë e verdhë e zhvilluar e pazakontë. Në mes është një element vezorë blu-jeshil me sipërfaqe të vogla të renditura në mënyrë ritmike. Në këndin e poshtëm djathtas është një zonë drejtkëndëshe jeshile, mbi të cilën shtrihet një figurë femërore me shpinë të kthyer, me flokë ngjyrë portokalli të verdhë dhe fustane verdhë-gjelbër dhe kafe. Përveç shtyllave dhe mureve, arkitektura përbëhet nga elemente katrore. Mbi arkitekturën është qielli i lehtë rozë dhe blu. Është përdorur teknika vaj në pëlthurë, dhe përmasat e veprës janë 140 x 193 cm.⁴⁵ Vepra nuk është e nënshkruar dhe autori është Smail Karailo.⁴⁶



foto: *Vladičina bašta*, Smail Karailo

Piktura *Fusha e Ulqinit*

Piktura paraqet një panoramë të gjerë horizontale të zonës bregdetare të parë nga lart, drejt bregut të gjatë dhe detit. Në plan të parë shihen dy shkëmbinj të mëdhenj dhe disa më të vegjël, mbi të cilët, në të djathtë, ka një gardh të gërshetuar me thurje që mbyll zonën e pyllëzuar në të cilën ka pemë me kurora të harlisur dhe stog sanë. Në anën e majtë mund të shihni një shteg që na çon në shtëpinë pranë së cilës ka stog sanë. Midis planit të parë dhe detit ndodhet zona kodrinore me kalime të buta të dhëna në perspektivë dhe në thellësi, dhe drejt bregut kalon në fushë. Në fushë, shihet një brez blu i hapur, që mund të përfaqësojë lumin. Bregdeti gradualisht shkrihet dhe vërshon me detin, i cili është në kontakt me tokën. Deti është ngjyrë të gjelbër-blu, dhe me thellësi kalon në nuanca

⁴³ *Hareme*, Inventari i Muzeut të Artit, numri i inventarit 488.

⁴⁴ Refik Adroviq (1941-1993), piktor dhe mësues i artit. Pikturoi peizazhet amtare të Beranës dhe rrethinave të tij. L. Zekoviq, *Adroviq, Refik*, Leksiku i Arteve të Malit të Zi, CANU 2022, <https://bp.etf.ac.me/leks/web/llucg.php?OID=3114> (aksesuar me 22. 03. 2024).

⁴⁵ *Kopshti i Vladikës*, Inventari i Muzeut të Artit, numri i inventarit 770.

⁴⁶ Smail – Smajo Karailo (1940 –) piktor dhe profesor. I përket stilit neo-romantik. Ka organizuar ekspozita të shumta të pavarura brenda dhe jashtë vendit. Lj. Zekoviq, *Karailo, Smail Smajo*, Leksiku i Arteve të Malit të Zi, CANU 2022, <https://bp.etf.ac.me/leks/web/llucg.php?OID=3467> (aksesuar me 22. 03. 2024).

të ndryshme të blusë. Deti, nga skaji i majtë në të djathtë, mbyll kodra dhe lugina me ngjyrë blu të hapur, vetëm horizonti në anën e djathtë takon qiellin. Qielli drejtpërsëdrejti mbi male dhe deti është i verdhë i lehtë dhe kthehet në blu nga lart. Është përdorur teknika vaj në pëlhurë, me përmasa 81 x 147.5 cm.⁴⁷ Autori është Pero Poçek, dhe nënshkrimi i tij *Potchek* është poshtë në të djathtë.⁴⁸



foto: Fusha e Ulqinit, Pero Poçek

Piktura Shën Stefani

Motivi i Shën Stefanit i rrethuar nga deti, ngjyrë gri, kafe-jeshile, kisha që dominon në shfaqje. Në plan të parë është rripi i ngushtë midis sipërfaqes së detit që e lidh me breg. Teknika është vaj në pëlhurë, ndërsa përmasat e veprës janë 90.5x115.⁴⁹ Autori i pikturës është Milo Milunović.⁵⁰



foto: Shën Stefani, Milo Milunović

⁴⁷ *Fusha e Ulqinit*, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 406.

⁴⁸ Pero Poçek (1878–1963) është piktori i parë i shkolluar nga territori i Principatës së Malit të Zi. U shkollua në Akademinë prestigjioze të Napolit, si bursist i pallatit malazez. Pasi mbaroi shkollën u kthye në Mal të Zi. Ndër veprat me temë malazeze, veçohen Nga rrethinat e Cetinës, Funelari në Lovqen, Ura në Lumin Crnojeviq, Gryka e Kotorrit, dhe cikli i tij më i famshëm është 37 skena nga Gorski vjenac. N. Martinović, Poçek, Pero, Leksikon i Arteve të Malit të Zi, CANU 2022, <https://bp.etf.ac.me/leks/web/llucg.php?OID=3785> (aksesuar me 23. 03. 2024).

⁴⁹ *Shën Stefani*, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 295.

⁵⁰ Milo Milunović (1897–1967), u shkollua në Itali dhe pas fillimit të Luftës së Parë Botërore u lajmërua si vullnetar në ushtrinë malazeze. Shpesh herë ka ndërruar vendbanimin dhe pas Luftës së Dytë Botërore punoi si profesor në Shkollën Artistike të sapothemeluar në Cetinë dhe në vitin 1947 u bë drejtues i Punëtorisë Shtetërore të Masterit të Arteve të Bukura në Beograd. Krahas pikturave ka bërë mozaikë, skena, kostume, postera...L. Zeković, *Milunović, Milo*, <https://bp.etf.ac.me/leks/web/llucg.php?OID=3643> (aksesuar me 23. 03. 2024).

Arti sakral

Që nga paraqitja e krishterimit, mund të identifikohet arti i krijimit të “imazheve të shenjta”. Pas Ediktit të Milanos dhe pranimit të krishterimit nga shteti romak, feja e re u përhap në territorin e Malit të Zi të sotëm, kështu që tashmë në shekullin e V filloi të zhvillohet arti sakral i krishterë - arkitektura, piktura, letërsia... Ndërsa kufiri i përçarjes së krishterimit kaloi territorin e Malit të Zi, arti sakral u ndikua si nga Lindja ashtu edhe nga Perëndimi.⁵¹ Muzeu Kombëtar ka në koleksionin e tij një numër të madh objektesh që dëshmojnë për artin e pasur sakral dhe zhvillimin e tij. Bëhet fjalë për ikona, kopje afreskesh dhe piktura me motive të krishtera.

Kopja e afreskut Portreti i themeluesit të mbretit Mihail

Kopija e afreskut original nga kisha e Shën Mihailit në Ston (Kroaci), krijuar në periudhën ndërmjet viteve 1077 dhe 1150. Kompozicioni është vendosur në një hapësirë të rrethuar me një bordurë të kuqe. Në sfondin katër ngjyrësh: jeshile e çelur dhe e errët, blu e hapur dhe e kuqe, është e shfaqur figurë mashkullore e kthyer në gjysmë profili djathtas me model të kishës në duar. Ai është i veshur me veshje ceremoniale: fustanin e poshtëm të zbukuruar bujarisht me imitim perlash, fustanin e sipërm ngjyrë lejla të çelët me pala blu dhe mantelin e zbukuruar me ornamente gjeometrike.⁵² Figura themeluese është identifikuar si Mbreti Mihailo Vojislavljeviq, sundimtar i Duklës (1046 - 1082). Në kokë mban kurorë mbretërore të stilit perëndimor, ndërsa në duar mban një model të kishës në Ston, të cilën ia dhuron kryeengjellit Mihail.⁵³ Afresku origjinal ndodhet në zonën e parë të naosit të kishës së Shën Mihailit (muri perëndimor). Kopja është realizuar me teknikën e temperës në pëlhurë, me përmasa 150 x 104,5 cm. Autori është i panjohur.⁵⁴



foto: Kopja e afreskut Portreti i themeluesit të mbretit Mihail, autori i panjohur

⁵¹ A. Çilikov, *Ikonat në Mal të Zi*, Podgoricë 2014, fq. 9-11.

⁵² *Portreti i themeluesit të mbretit Mihail*, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 29.

⁵³ T. Koprivica, *Ston në Peleshac, Kisha e Shën. Mihailit*, Leksiku i arteve figurativ të Mali të Zi, CANU 2022, <https://bp.etf.ac.me/leks/web/llucg.php?OID=3922> (pristupljeno 22. 03. 2024).

⁵⁴ *Portreti i themeluesit të mbretit Mihail*, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 29.

Kopja e afreskut Shën Ilia bekon bukën dhe verën e vejushës

Kopja e afreskut original është nga manastiri Moraça dhe në të është i paraqitur Shën Ilia me aureolë në kokë dhe një figurë femërore në këmbë që mban bukë në shami të bardhë. Shenjti ka mjekër dhe flokë të thinjura, është i veshur në mantel dhe mban dorëshkrim të hapur në dorën e djathtë. Mbi të është i shkruar një tekst në dy rreshta. Gruaja është në gjysmë profil përballë shikuesit, e vendosur te hyrja e një ndërtese të stilizuar - një kullë, me bordurë të kuqe si në pjesën e sipërme ashtu edhe në atë të poshtme. Ngjyra e mishit është nuancë okër, me hije të jeshile të pakët, ndërsa disa pjesë të caktuara të fytyrës janë të theksuara me ngjyrë të bardhë dhe vija të errëta. Elementet arkitekturore janë realizuar në tonalitete rozë dhe nuk janë në përpjesëtim me përmasat e figurave. Afresku original është në diakononin e manastirit të Moraçës. Autorët dhe kopjes janë Aleksandar Tomasheviq dhe Shime Periq, ndërsa është përdorur teknika e temperës në pëlhurë. Përmasat e kopjes janë 205 x 124 cm dhe është krijuar në vitin 1951.⁵⁵



foto: Kopja e afreskut Shën Ilia bekon bukën dhe verën e vejushës, Aleksandar Tomasheviq dhe Shime Periq

Ikona e Virgjëreshës Filermosa⁵⁶

Ikona e Virgjëreshës është bërë me teknikë të kombinuar - koka e pikturuar, busti është prej metali (aplikim në ar). Pjesët e fytyrës që janë mezi të dukshme dhe siç mund të kuptohet, janë realizuar me një teknikë të hollë dhe delikate dhe me një shtresë shumë të hollë ngjyre. Ngjyra e mishit është në tonet kafe të errëta. Ekspresiviteti i fortë i shprehjes, karakteristik për mënyrën dhe përshkrimin bizantin të shenjtorit, theksohet pikërisht nga sytë e mëdhenj të zinj të nënvizuar nga vija të trasha të zeza, hundë e hollë, të gjatë dhe përkulur dhe buzët e grumbulluara. Pjesët e vizatuara të fytyrës janë mjaft të dëmtuara. Ngjyra mungon në

⁵⁵ Shën Ilia bekon bukën dhe verën e vejushës, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 3.

⁵⁶ Ikona së bashku me pjesë të kryqit dhe dorën e Gjon Pagëzorit, është një nga tre reliket e krishtera që ruhen në Cetinë. Sipas besimit, ikona është pikturuar nga modeli i gjallë nga Luka Ungjilltari në shekullin e parë pas të erës së re. Megjithatë, rruga e saj historike mund të gjurmohet që në vitin 1395, kur Kalorësit e Shën Gjonit e sollën atë nga Toka e Shenjtë në Rodos. Atë e vendosën në kishën në kodrën Filermos, pas së cilës ikona mori emrin. Me pushtimin osman të Rodosit në 1522, Jovanët u zhvendosën dhe ikonën e çuan në Maltë. Ajo u mbajt atje deri në vitin 1799 kur, për shkak të pushtimit të ishullit nga Napoleoni, kalorësit e Maltës e çuan ikonën në Rusi dhe ia paraqitën perandorit rus Paul I. Pas Revolucionit të Tetorit, ajo u transferua fillimisht në Kopenhagë, pastaj në Berlin dhe në fund në Beograd. Gjatë Luftës së Prillit, ikona u zhvendos në Mal të Zi dhe u fsheh në manastirin Ostrog, së bashku me dy relike të tjera. Autoritetet jugosllave e gjetën ikonën në vitin 1952 dhe e vendosën në thesarin e Qeverisë së Malit të Zi. Në vitin 1978, ikona iu dorëzua Muzeut Kombëtar, ku gjendet edhe sot. <https://narodnimuzej.me/2020/12/23/ikona-bogorodice-filermose/> (aksesuar me 22. 03. 2024).

zonat e anës së majtë të fytyrës. E gjithë sipërfaqja e pikturës është brazda me çarje të vogla. Figurë e errësuar. Vijat e fytyrës së zgjatur, pak të anuar djathtas, ndiqen nga një aureolë luksoze, përgjatë skajit të brendshëm të së cilës kalon një tel i hollë i përdredhur i artë. E gjithë sipërfaqja e ikonës është me zinxhir të artë, të zbukuruar me gurë të çmuar (rubinë, safirë, diamante). Aureola përbëhet nga një pjesë e veçantë e bërë në sipërfaqen e artë të ikonës mbi rrezet e smaltit të bardhë të rrobave (ndoshta krahët e kryqit maltez). Është e zbukuruar me bordurë prej 232 diamantesh të përmasave të ndryshme. Veshja e Virgjëreshës është gjithashtu me ar dhe e zbukuruar me gurë të çmuar. Bordura me dy rreshta në pjesën e qafës, në pjesën e sipërme përmban 18 diamante dhe 1 spitler në anën e djathtë, dhe në atë të poshtme 29 diamante dhe një spitler në të dy anët. Sipërfaqja midis kufijve është e zbukuruar me 4 safirë të veshur me diamante. Më i majti është i veshur me 16 diamante pa ngjyrë. Rreth safirit të dytë në të majtë janë 19 diamante, të cilët ndryshojnë në madhësi. Ikona u krijua në Jerusalem gjatë shekullit të XII, nga autori i panjohur. Është punuar me teknikën vaj në pëlthurë, me përmasa 50,4 x 39,7 cm.⁵⁷



 foto: Ikona Virgjëresha Filermosa, autori i panjohur

Ikona e Dyzet Martirëve

Është krijuar gjatë shekullit të XVIII në shkollën e pikturës Dimitrijeviq-Rafailoviç.⁵⁸ Në hapësirën qendrore drejtkëndore, të kufizuar nga një kornizë paksa të profiluar në sipërfaqen e një pllakë druri, vendin qendror e përbëjnë 40 martirë, të zhveshur deri në bel, me pantallona okër të bardhë, mbi akull gri-blu. Në të djathtë të grupit qendror është i vizatuar mbikëqyrësi, në momentin kur ka hequr rrobën e kuqe dhe bëhet gati t'i bashkohet. Ai ka hedhur shpatën, me dorezë të kuqe-gri, këllëf të kuq dhe shaptën. Në anën e majtë të ikonës është paraqitur arkitektura e stilizuar me një derë, banja e nxehtë. Pjesa e gjysmë zhveshur, e cila sapo ka kaluar nga dera, përfaqëson një nga 40 martirë që nuk duron dot të ftohtin. Peizazhi kodrinor në sfond është pikturuar në okër

⁵⁷ Virgjëresha Filermosa, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 3024.

⁵⁸ Shkolla u themelua në Risan nga Dimitrije Daskal në gjysmën e dytë të shekullit të XVII. Dimitrije njëhej si një piktor i shkëlqyer ikonash dhe veprat e tij zbukurojnë kishën e Shën. Pjetrit dhe Palit në Risan (*ikona e Jezu Krishtit*), kisha e Shën Nikollës në manastirin Dubočica afër Plevlës (*ikonostasit*), kisha e Shën Luka në Kotorr (*Nedriemano oko dhe Mikpritja e Avramit*), manastiri Moraça (*Fjetja e Virgjëreshës Mari*) dhe të tjerë. Katër djemtë e tij vazhduan tregtinë e pikturës dhe u emëruan Daskaloviçi ose Dimitrijeviçi sipas babait të tyre. Më i famshmi prej tyre është Rafaelo. Ai pikturoi ikonat në Manastirin e Pivës (*Shën Nikolla me tre Hierarkët*, *Shën Gjon Pararendësi me skena nga jeta e tij*), Manastirin e Savinës (*Fjetja e Virgjëreshës*) etj. A. Çilikov, *Ikonat në Mal të Zi*, Podgoricë 2014, fq. 98-115.

dhe cinober me gurë të nënvizuar me vija gri dhe të bardhë. Krejt lart, në segmentin rozë okër të qiellit, gjysmërrethor me yje okër, Krishti është paraqitur në bust duke bekuar martirët, me një tunikë të kuqe dhe një himation blu, me aureolë të artë rreth kokës. Të mishëruarit trajtohen me të bardhë për zonat e ndriçuara dhe hijet gri të gjelbërta. Pozicionet e ndryshme të trupave të martirëve synojnë të sugjerojnë gjendjen e tyre psikologjike. Struktura e trupit është veçanërisht e theksuar. Flokët janë kafe, sytë janë të shënuar me një pikë të errët. Ngjyra është e ndezur, e kombinuar me ngjyra okër, të bardhë dhe ulliri. Është bërë duke përdorur teknikën e temperës në dërrasë. Dimensionet janë 24 x 31 cm.⁵⁹

foto: *Dyzetë Martirë*,
shkola Dimitrijeviq-Rafailoviq



Ikona Krishti



foto: *Krishti*,
shkola Dimitrijeviq-Rafailoviq

Figura qendrore e Krishtit është e vendosur në një hapësirë të kufizuar nga një kufi me bordurë. Sfondi dikur ishte i gjelbër dhe i artë, duke gjykuar nga mbetjet. Figura frontale e Krishtit është e veshur me tunikë të kuqe cinober dhe himation blu-gri. Krishti bekon me dorën e djathtë dhe me të majtën, të fshehur nën himation, mban një kopertinë të mbyllur të Ungjillit cinober. Palosjet e himationit janë të shënuar në të bardhë. Në të majtë dhe në të djathtë të Krishtit janë pikturuar: në të majtë - kokë femërore dhe mashkullore, në të djathtë - burrë si plak me mjekër dhe kokë gruaje. Aureola janë bërë me një vijë të vetme të hollë të gërvishtur. Nga figurat e paraqitura mbi Krishtin, ka mbetur vetëm një vizatim. Ngjyra e trupit të Krishtit është bërë në gri-bardhë dhe të bardhë në pjesët më të ndriçuara dhe ngjyrë ulliri për hijet. Ikona është bërë duke përdorur teknikën e temperës në dërrasë, dhe përmasat janë 35 x 25,7 cm. Është krijuar në Shkollën e Pikturës Dimitrijeviq-Rafailoviq.⁶⁰

⁵⁹ *Dyzetë Martirë*, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 265.

⁶⁰ *Krishti*, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 415.

Piktura *Familja e shenjtë*

Në hapësirë të papërcaktuar, kafe-jeshile, përballë arkitekturës, nga e cila, në këndin e sipërm majtas, shihet një pjesë e shtyllës dhe në pjesën e poshtme djathtas të një stoli prej guri, janë tre figura. Figura në të majtë ka një aureolë rreth kokës dhe përfaqëson Virgjëreshën. Ajo është ulur në një stol prej guri, e veshur me një fustan rozë-kafe dhe mantel të gjelbër të errët që i bie përtokë mbi gjurin e saj të majtë. Ajo ngrii dorën e djathtë në lartësinë e shpatullave dhe mban një gjerdan në dorë. Me dorën e majtë, mban një figurë fëmijësh të zhveshur, në këmbë, që përfaqëson Jezus Krishtin. Koka e Virgjëreshës është e sjellur drejt Krishtit dhe vështrimi i saj drejtohet lart. Krishti mbështetet në shpatullën e Virgjëreshës me dorën e djathtë dhe mban një gjerdan me të djathtën. Në anën e djathtë, pak të tërhequr mbrapa, me ngjyrë më të errët dhe të hapur, është një gjysmë figurë e një shenjtori me aureolë rreth kokës dhe mjekër gri. Shenjtori është i veshur me kostum jeshil të errët dhe perde kafe i bie mbi krahun e majtë dhe gjurin e tij. Me dorën e djathtë mban një shkop mbi të cilin ka forma në formë botësh. Piktura është bërë nga Tripo Kokola, dhe nënshkrimi i tij *Cocglia* është në këndin e poshtëm djathtas.⁶¹ Ai përdori teknikën vaj në pëlhurë. Përmasat e fotos janë 64 x 50 cm.⁶²



foto: *Familja e Shenjtë*,
Tripo Kokola

Piktura *Familja e Shenjtë*

Në pikturë shihen Virgjëresha, Krishti i vogël dhe Shën Gjoni. Ata janë të vendosura në një mjedis të papërcaktuar në të cilin ndahen pjesët e arkitekturës në anën e djathtë dhe disa perde të gjelbra në të dyja anët. Sfondi, i cili ka rreze drite nga lart në të djathtë, është okër i verdhë. Grupit i bashkohet edhe Shën Gjoni në sfond. Figura e Krishtit është vendosur në perde të bardhë, në prehrin e Virgjëreshës. Shën Gjoni i vogël luan me qengj dhe është i vendosur në skajin e poshtëm të majtë të figurës. Karakteristikë tek Virgjëresha është aureoli mezi i dukshëm, fustani rozë dhe manteli jeshil. Figura e ulur e shenjtorit është dhënë me tone më të errëta dhe karakterizohet nga flokët dhe mjekra, ngjyra e lëkurës portokalle dhe perde kafe me detaje blu të verdhë dhe gri. Krishti është paraqitur me në fustan gri-jeshile me duar të bashkuara dhe këmbët të përkulura në gju.

⁶¹ Tripo Kokola (1661 – 1713) është një nga piktorët më të mirë barok të Bokës së Kotorrit dhe kompozimet e tij në Zojës së Shkëmbinjve ende mbresëlënëse. Ai ishte i pari që futi dekorime të pasura bimore me shtretër lulesh dhe natyrë të vdekur në pikturën tonë baroke. Kokola pikturon në frymën e barokut venecian. P. Mijoviq, *Thesari artistik i Malit të Zi*, Titograd 1980, fq. 181.

⁶² *Familja e Shenjtë*, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 200.

Autori i pikturës është Tripo Kokola i cili ka përdorur teknikën e temperës në dërrasë. Nënshkrimi i tij *Cocoglia* është në këndin e poshtëm të djathtë. Piktura u krijua në fund të shekullit të XVII. Përmasat e veprës janë 35 x 29.5 cm.⁶³



foto: *Familja e Shenjtë*,
Tripo Kokola



Traditat e varrimit

Kulturat e ndryshme, të cilat ishin të pranishme në të kaluarën malazeze, lanë pas praktika të ndryshme kulturore. Domethënë, mënyrat e trajtimit dhe të lidhjes me të ndjerin kanë qenë gjithmonë të lidhura ngushtë me besimet dhe praktikat jetësore të kulturave dhe komuniteteve të ndryshme që kanë jetuar në të kaluarën dhe kanë qenë përfaqësuese në kohën e tyre. Kështu, pas kulturave, të cilat pa mëdyshje i njohim nga e kaluara malazeze, mbetën dëshmi që dëshmojnë për ritualet e varrimit. Gjatë shekujve, madje edhe mijëvjeçarëve, ka paraqitje të formave të ndryshme të varrimit, të cilat kanë shënuar kohë, popuj dhe kultura të ndryshme. Muzeu Kombëtar i Malit të Zi trashëgon shembuj të ndryshëm të derivateve kulturore të lidhura drejtpërdrejt me zakonet e varrimit, nga varret e hershme të epokës së hekurit deri te varrimet moderne që datojnë dy shekuj më parë.

Urnë qelqi dhe guri

Urna prej qelqi ka formë të rumbullaktë, me pjesën qendrore të fragmentuar me dy vegje të gjera vertikale të profilizuara. Urna është prej xhami me ngjyrë të gjelbër dhe ka një fund pak të prerë.⁶⁴ Urna prej guri, në formë konike me kapak të sheshtë dhe tre

⁶³ *Familja e Shenjtë*, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 201.

⁶⁴ *Urnë qelqi*, Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër broj 81.

pajisje plumbi. Gjurmët e gdhendjes duken qartë si nga jashtë ashtu edhe nga brenda.⁶⁵ Varrimi u krye me djegjen e trupit të ndjerit dhe më pas hirin e derdhnin në urnë xhami. Ajo urnë vendosej në një urnë guri me kapak dhe vihej në varr si e tillë.

foto:
a. Urnë qelqi,
b. Urnë guri



Guri i varrit me përshkrim të Mërkurit

Monumenti i gurit të varrit e ka origjinën në shekullin II-III të erës sonë dhe u gjet në Dukël. Në pjesën e sipërme të monumentit është paraqitur perëndia romake Mërkuri. Mërkuri është perëndia e tregtisë dhe udhëtimit, lajmëtari i perëndive dhe udhërrëfyesi i shpirtrave në botën e nëndheshme. Ai është një nga 12 perënditë e panteonit romak. Figura e perëndisë është kthyer *en face*. Në dorën e majtë mban kaducei (shkop me dy gjarpërinj të ndërthurur, që është simbol i paqes dhe harmonisë, si dhe i tregtisë) dhe me të djathtën mbështetet në shkop. Në kokë mban kapelë me krahë - petale. Lartësia e figurës është 37 cm. Pjesa e poshtme e monumentit nuk është e zbukuruar.



foto: Guri i varrit që
përshkruan perëndinë Merkur

Sarkofag

Sarkofagu prej guri me kapak me dy pjesë dhe zgjatime të rrumbullakta si gunga në skaje, pothuajse deri në lartësinë e çatisë. Sarkofagu është pa dekorime plastike. Në kapak janë shkruar germet fillestare të formulës së shenjtë D. M. S., e cila është në përdorim që nga epoka e Augustit. D(is) ndodhet në gungën këndor, M(anibus) në mes të skajit anësor të kapakut dhe S(acrum) në gungën e dytë këndore.⁶⁶ Në mes të sarkofagut, në një drejtkëndësh 50,5 x 35,5 cm të kufizuar nga një brez pllake 4 cm të gjerë, është shkruar me shkrim



foto:
Sarkofag guri

⁶⁵ Urnë guri Inventari i Muzeut të Artit, inventari numër 151.

⁶⁶ Sarkofag, Inventari i Muzeut Shtetëror, numri i inventarit 149.

monumental romak mbishkrimi: P. CORNELIO / IVLIO QVI VIXIT / AN LV IVLIA ET / IRENE FILLAS / PATRI PIENTIS / SIMO⁶⁷. Sarkofagu u gjet në tokë në Zagoriç në vitin 1904, kur një fermer nga Piperi e goditi me parmendë teksa punonte tokën. Sarkofagu u ble nga kapiteni i atëhershëm Niko Stankov Martinoviq, i cili donte që ti shërbente si varr. Megjithatë, shteti shpronësoi sarkofagun dhe Martinoviqi mori 1050 perpera si kompensim.⁶⁸

Balsamarium

Balsamarium i gjatë qelqi, në formë gishti, me pjesën qendrore të gjatë të ngushtë të fragmentuar. Balsamariumi u gjet në vitin 1938 në nekropolin e Budvës, gjatë gërmimit të themeleve për hotelin Avala.⁶⁹ . Sipas një interpretimi, balsamariumet përdoreshin për mbledhjen e lotëve dhe ai lloj quhej lacrimarium (*lacrima* - lot). Gjithsesi, kur i dashuri i një gruaje ndërronte jetë, ajo i mblidhte lotët gjatë zisë dhe i ruante si kujtim të të ndjerit.

foto:
Balsamarium



Vazo antropomorfe me pamjen e Janusit

Vazo argjile e pjekur antropomorfe me qafë cilindrike të derdhur, pjesën qendrore të zgjeruar dhe këmbë unazore të gjatë. Vazoja është në formën e kokës së njeriut me dy fytyra. Në njërin anë është fytyra e një të moshuari me mjekër, dhe nga ana tjetër fytyra e një të riu. Sipërfaqja është e lyer me llak të zi.⁷⁰ Mundësisht bëhet fjalë për perëndinë romak me dy fytyra - Janus. Ai është zot i fillimit dhe i fundit i të gjitha gjërave dhe muaji janar është emëruar sipas tij. Është paraqitur me dy figura përballë njëra-tjetrës nga anët e kundërta, në mënyrë që njëra shikon në fillim dhe tjetra në fund. Në këtë rast, i riu shikon nga fillimi, ndërsa i moshuari me mjekër drejt fundit. Vazoja u gjet në një nga varret e nekropolit të Budvës, pasi zakoni diktonte që sende të ndryshme futeshin me të ndjerin në varr, pasi besohej se do t'i shërbenin atij në jetën e përtejme.

foto:
a. Figura e një plak me mjekër,
b. Figura e një të riu



⁶⁷ Përkthim: Babait shumë i devotshëm P. Cornelius Julius, i cili jetoi 55 vjet, i rritur nga vajzat Julia dhe Irena..

⁶⁸ Gj. Batriqeviq, *Zhvillimi i shërbimit muzeor në Mal të Zi*, Cetinë 1998, fq. 59-60.

⁶⁹ *Balsamarium*, Inventari i Muzeut Shtetëror, numri i inventarit 76.

⁷⁰ *Vazo antropomorfe*, Inventari i Muzeut Shtetëror, numri i inventarit 53.



foto:
a. Kalorësi dhe dreri, fotogrametria;
b. Kryqi i stilizuar, fotogrametria

Gurë varri me kalorës

Në anën më të gjatë është e paraqitur skena e një figure antropomorfe duke ngarë një kalë. Përballë kësaj figure, shfaqet një dren me brirë të mëdhenj. Figura antropomorfe ka dorën e djathtë të shtrirë, të cilën e drejton në drejtim të drerit. Dora është e mbitheksuar në raport me pjesën tjetër të trupit. Kali që mban burrin ka një bisht të theksuar në formën e një zgjatjeje. E gjithë skena kufizohet me borudrë me vijë. Në anën tjetër më të gjatë, performanca qendrore është e zënë nga katër kamare bordura me vijë. Mbi skenë është një dredhim i vazhdueshëm me trefletë dhe katërkëmbëshe. Skena kufizohet me një kufi bordurë në formë vije. Në anën më të ngushtë është paraqitur një variant kryqi i stilizuar, me një rreth në mes, nga i cili shtrihen vija në formë dege, të cilët kanë breza shtesë të brendshëm, të thjeshtë. Në anën tjetër është paraqitur një variant kryqi i stilizuar. Në mes është i vizatuar një rreth, nga i cili shtrihen katër krahë në të katër anët, skajet e të cilit janë të thyer.⁷¹

Guri varri me figurë antropomorfe

Gurë varri i cili në tipologjinë arkeologjike karakterizohet si një *steqak* me kulm, sepse pjesa e sipërme përfundon në një formë bikonike që i ngjan çatisë (kulmit). Është zbukuruar në të katër anët, në pjesën e poshtme është më e vogël, ndërsa në pjesën e sipërme zgjerohet. Në njërin nga anët më të gjera, janë të theksuara kamaretë që të kujtojnë elemente nga arkitektura e kishës, një kolonadë shtyllash me harqe, mbi të cilat shihen shtatë rrathë të gdhendur me përmasa afërsisht të njëjta. Këtë paraqitje e mbulojnë vijat zigzag të theksuara në relief, mbi të cilat,



foto:
a. Figurë antropomorfe,
b. Kolonadë shtyllash

⁷¹ Gurë varri gjendet në lapidarium e Bilardës.

gjithashtu, pesë rrathë janë si gunga. Në anën tjetër të fragmentuar anësore më të gjatë, në zonën e poshtme vërehen elementë të paqarta për shkak të erozivitetit të gurit. Në pjesën e sipërme ka dy vija zigzage në relief, mbi të cilat është bordura e ngushtë drejtkëndore me rrathë të gdhendur. Në njërën nga anët më të ngushta duken tre rrathë të gdhendur, të vendosur në dy rreshta ku rrethi i sipërm qëndron në mënyrë simetrike mbi dy të poshtmet. Në anën tjetër më të ngushtë, është figura antropomorfe e stilizuar me krahë të shtrirë, e cila ka një paraqitje në formë aureolë rreth kokës që zgjerohet në formë shirti, e ngjashme me rrezatim.⁷²

Gurë varri me motive florale

Një gur varri mysliman prej guri nga pjesa jugore e liqenit të Shkodrës. Në pjesën e poshtme të pllakës është një rrënjë e madhe nga e cila shtrihen gjashtë kërcella. Nga katër kërcëjtë, dy në të majtë dhe dy në të djathtë, nuk shfaqet asnjë lule e zhvilluar, por vetëm sytha. Dy kërcellet e mbetura përfaqësohen sikur vazhdojnë të rriten drejt pjesës së sipërme të pllakës dhe katër kërcell të rinj zhvillohen nga ato. Nga këto kërcell të rinj, dy në secilën anë kanë sytha. Një kërcell nga e majta dhe një nga e djathta bashkohen në mes të pllakës dhe marrin një formë të përbashkët lulësh katërpetale. Dy kërcellet e mbetura vazhdojnë të rriten drejt majës së pllakës, ku bashkohen dhe krijojnë një motiv lulësh me katër petale. Pllaka është e fragmentuar në pjesën e sipërme djathtas, ku mungon fundi i gjithë shfaqjes. Është praktikë e zakonshme që ky lloj guri varri të gjendet në kontekstin e një shenje të poshtme/ulët të varrit, ku maja (koka) dekorohet ndryshe. Duke gjykuar nga kjo, varreza të tilla kishin dy gurë varri *nishan*.⁷³



 foto: Gurë varri me motive florale

Varri i Vladikës Danilo Petroviq - Njegosh

Varri i Vladikës malazez dhe paraardhësve të dinastisë Petroviq-Njegosh ndodhet në Orlov Krsh dhe është një nga monumentet e shenjta që i përket Muzeut Kombëtar. U krijua me rastin e kremtimit të 200 vjetorit që kur Danilo mori postin e episkopit. Projekti konceptual është realizuar nga mbretëresha italiane Jelena e Savojës, ndërsa përpunimi arkitektonik i tij është bërë nga arkitekti francez Fouche. Punimet u menaxhuan nga inxhinieri Andrija Radoviç. Është ndërtuar me gurë nga Luboviç, dhe mjeshtrit ishin nga Korçula dhe Mali i Zi. Mauzoleumi përbëhet nga dy pjesë, varri dhe tenda. Në piedestalin prej guri ndodhet varri në formën e një sarkofagu me kryq. Simbolet e autoritetit shpirtëror dhe botëror janë gdhendur në pllakë. Në pjesën e përparme është vendosur një medaljon bronzi i peshkopit Danilo, vepër e skulptorit francez Vautier. Mbi varr është një tendë me katër shtylla të holla. Në mes të harqeve të tendës janë gdhendur

⁷² Njësoj.

⁷³ Gurë varri me motive florale, Inventari i Muzeut të Arkivit.

stema të ndryshme: stema familjare e dinastisë, stema episkopale dhe stema shtetërore. Pjesa e brendshme e tendës është blu me yje të artë, që përfaqëson qiellin me yje.⁷⁴



foto: Varri i Vladikës Danilo Petroviq - Njegosh



Gjurmët e shkruara në Mal të Zi

Fjala e shkruar ka qenë e pranishme në territorin e Malit të Zi që nga shekulli i VI para Krishtit, kur grekët themeluan ekonominë e tyre në Budva dhe sollën shkrimin grek. Shekuj më vonë, me ardhjen e romakëve, gjuha greke fitoi konkurrencë nga latinishtja, e cila dalëngadalë u bë dominuese në të gjithë territorin e Malit të Zi, nga bregu në veri (Municipium S). Dominimi i gjuhës latine filloi të dobësohej me shfaqjen e sllavëve, në shekujt VI-VII të erës sonë, të cilët vërshuan Ballkanin. Së shpejti sllovenët, falë punës së vëllezërve të Selanikut Kiril dhe Metodi, morën shkrimin e tyre - glagolikë, dhe më vonë cirilik. Ndikimi i fundit vjen nga osmanët, të cilët nga shekulli i XV filluan të kontrollojnë Malin e Zi dhe sollën me vete shkrimin arab.

Gurë oltari kushtuar Neptunit

Oltari prej guri të bardhë gëlqëror, dedikuar Neptunit, perëndisë së detit. Shkronjat në të janë të gdhendura me kapitule rustike me madhësi dhe gjerësi të pabarabartë rreshtash dhe shkronjash. Shkronja O në fund në rreshtin e parë dhe shkronja V në rreshtin e tretë janë të paplota, sepse ajo anë për një kohë të gjatë ishte e ekspozuar ndaj vërshimit nga pjesa e sipërme e rrjedhës së lumit, dhe u gërrye nga uji. Kjo është arsyeja pse akroteria, në anën e sipërme, është gërryer deri në atë masë sa që medaloni relief në të është i ruajtur

⁷⁴ M. Jovičević, T. Pejović, M. Lompar, *Cetinë*, Cetinë 1986, fq. 110. Mauzoleumi i Vladikës Danilo është një nga tre mauzoleumet që ndodhen brenda Muzeut Kombëtar. Dy të tjerat janë Mauzoleumi i Njegoshit në Lovćen dhe Muzeu i Sundimtarëve malazezë - Kisha e Pallatit në Qipur, ku janë varrosur mbreti Nikolla, mbretëresha Milena dhe Zoti i Malit të Zi dhe themeluesi i Cetinjes Ivan Crnojević.

vetëm pjesërisht. Është e qartë se shkronjat janë gdhendur nga një mjeshtër i pakualifikuar. Mbishkrimi është gdhendur në tetë rreshta të pabarabarta të lartësisë, gjerësisë dhe formës së shkronjave. Në oltar është shkruar: NEPTVNO / SACRVM P / ERICVLORV / M ABSOLV / TORI PETRO / NIVS ASPE / R V(otum) S(olvit) / L(ibens) A(nimo). Në përkthim, kjo do të thotë: Neptunit, shpëtimtarit nga rreziku i vdekshëm, i kushtoi Petronius Asper-it me një mendim solemn. Është gjetur në vitin 2003 dhe daton në shekullin II ose III pas Krishtit.⁷⁵



foto: Gurë oltari
kushtuar Neptunit



Ungjilli i Miroslavit

Ungjilli u krijua në kishën e Shën Pjetrit dhe Palit në Bijello Pole në fund të shekullit të XII. Është porositur nga Miroslavi, Duka i Humit, vëllai i Stefan Nemanjës. Është shkruar në gjuhën e vjetër sllave, në pergamenë të hollë dhe ka gjithsej 181 fletë, me përmasa 41,5 x 28,4 cm, me tekst të shkruar në dy kolona. Ungjilli shquhet për miniaturat e tij, nga të cilat janë gjithsej 296. Tekstin e kanë punuar dy shkruar me drejtshkrime të ndryshme. Pjesën më të madhe të tekstit e ka shkruar një shkruar anonim (drejtshkrim Zetë-Hum), ndërsa pjesët më të vogla nga Gligorija Dijak (rejtshkrim Rashka). Besohet se Ungjilli u krijua si rezultat i simbiozës së traditave të vjetra sllave dhe ndikimeve kulturore perëndimore.⁷⁶



foto: Botim fototip i
Ungjillit të Miroslavit

Oktoih me pesë zë

Shtypshkronja e Crnojeviqit filloi të punojë në vitin 1493, kur Gjuragj Crnojeviq solli një shtypshkronjë nga Venediku. Ishte shtypshkronja e parë cirilike ndër sllavët e jugut dhe e dyta ndër sllavët në përgjithësi. Jeromonaku Makarije shtypi pesë inkunabula në të deri në vitin 1496: Oktoih me zë të parë, Oktoih me pesë zë, Trebnik, Katër Ungjijtë dhe Psaltir. Libri më i bukur është Oktoih me pesë zë, pasi është e vetmja inkunabula e ilustruar e Cetinës.

⁷⁵ J. Martinović, *Mbishkrim i lashtë në Mal të Zi*, Podgoricë 2011, fq. 130-131. Oltari prej guri ndodhet në Muzeun Historik..

⁷⁶ S. Qirković, D. Bogdanović dhe të tjerë, *Historia e Malit të Zi libri 2, tom 1*, Titograd 1970, fq. 96-101. Departamenti i bibliotekës dhe arkivit posedon një botim fototip të Ungjillit të Miroslavit nga viti 1897. Numri i inventarit A2026..

Në ilustrimet e saj mund të shihet se si dukej oborri i Ivan Crnojeviqit dhe Manastiri i Cetinës në Qipur. Një nga gjashtë ilustrimet ruhet në muze, përkatësisht *Rrëfimet e Krishtit*. Të gjitha ilustrimet e gjetura deri më tani kanë një kornizë identike, ndërsa kompozimet ndryshojnë në fushën e brendshme. Fusha e brendshme është e përbërë në formën e një katrori dhe gjysmërrethi mbi të. Katrori simbolizon hapësirën tokësore, dhe gjysmërrethi hapësirën qiellore.⁷⁷ Poshtë fushës së brendshme është një shqiponjë me dy krena - stema e Crnojeviqëve, nga e cila burojnë elementët floralë që zbukurojnë kornizën e ilustrimit. Mbi fushën e brendshme është një engjëll që ikën nga një dragua në krahët e luanit. Ungjilltarët janë paraqitur në qoshet e ilustrimit: Gjoni (lart majtas), Mateu (lart djathtas), Luka (poshtë majtas) dhe Marku (poshtë djathtas). Në fushën e brendshme, ilustrohet puthja me të cilën Juda Iskarioti denoncoi Jezus Krishtin tek autoritetet romak. Në fund mund të shihni apostullin Shën Pjetrin që ia pret veshin Malkiut, shërbëtorit të kryepriiftit. Në sfondin e kompozimit janë gjashtë figura që përpiqen të kapin Jezusin, ndërsa sipër kompozimit qëndron mbishkrimi cirilik i vjetër sllav *Rrëfimet e Krishtit*.⁷⁸



 foto: Ilustrim *Rrëfimet e Krishtit*



Transkripti i Kuranit

Një tekst plotësisht i vokalizuar arab, i shkruar me shkrim mjaft të bukur të ashtuquajtur "neshi", në letër të imët antik "abadi". Në fillim mungojnë tre fletë dhe më pas edhe më shumë. Ato fletë më vonë janë shkruar me dorë të pakualifikuar në letër të thjeshtë, me të cilën u arnuan edhe vrimat në disa fletë. I lidhur në lëkurë marokene të errët (*maroquin*), dhe një dekoratë në relief është stampuar në të dy kopertinat. Formati i librit është 13 x 19 cm, dhe skajet janë të rrumbullakosur. Vepra u transkriptua nga Mehmed Mustafa në vitin 994 të kalendarit të hixhrit, d.m.th., 1586 pas Krishtit.⁷⁹

 foto: Një faqe e Kuranit

Mbishkrim arab në jatagan

Një teh i lakuar, i cili ka një ornament lulesh të gdhendur përgjatë gjithë gjatësisë nga të dyja anët. Në njërën anë, teksti i mbishkruar: 1198. *Bërë nga Ibrahim, pronari Ahmed aga. Jeta nuk*

⁷⁷ B.Borozan, *Deklarata e fshehur e gdhendjes nga Oktoih i Cetinës*, Matica nr. 44, fq. 620.


⁷⁸ Ilustrimi ndodhet në Departamentin e Bibliotekës dhe Arkivave.

⁷⁹ *Kurani* ndodhet në Departamentin e Bibliotekës dhe Arkivave.

është ajo që mbetet në këtë botë. Mjerimi, megjithatë, është se bota i mbet atë që shpëton. Kjo botë është e këndshme dhe kur të vijë vdekja duhet të ndahesh prej saj. Parazvana në dorezën prej bronzit, e vendosur horizontalisht me një unazë dhe tel të përdredhur të ndarë në dy fusha me nga tre radhë rrathësh teli të përdredhur. Doreza është prej kocke të bardhë, ndërsa tehu është i gjatë 53.4 cm. Jatagani është farkëtuar në vitim 1783.⁸⁰



 foto: Jatagan me mbishkrim arab



Gramatika shqipe nga viti 1887

Biblioteka e pallatit ka në koleksionin e saj librin *Grammaire Albanaise* nga vitit 1887. Libri është shtypur në Londër, në frëngjisht, si pjesë e edicionit “*Parimet e thjeshtuara gramatikore për gjuhët aziatike dhe evropiane*”. Kjo gramatikë dëshmon se disa anëtarë të shtëpisë sunduese Petroviq-Njegosh dhe zyrtarët e tyre dëshironin të mësonin bazat e gjuhës shqipe për të komunikuar me nënshtetasit e tyre shqiptarë.⁸¹

 foto: Faqja e parë
Grammaire Albanaise

Instrumentet muzikore

Instrumentet muzikore dhe muzika tradicionale në Mal të Zi u krijuan nën ndikime të ndryshme, ku në të njëjtën kohë u ruajt specifika e shprehjes muzikore. Instrumente si lahuta, fyelli, duduk, jo vetëm që lidhen me një grup kombëtar, por mund të gjenden në të gjitha anët e vendit. Shembulli më i mirë është fyelltari Avdo Megjedoviq nga Bijello Pole, të cilin profesorët e Harvardit e quanin *Homeri ballkanik*. Muzeu Kombëtar ka instrumente muzikore që dëshmojnë se grupe të ndryshme kombëtare trashëgojnë të njëjtat objekte muzikore.

⁸⁰ Jatagan, Inventari i Muzeut Shtetëror, numri i inventarit 469.

⁸¹ *Grammaire Albanaise*, Departamenti i bibliotekës dhe arkivit, numri i inventarit 7850.

Lahuta me Malazez

Lahuta është bërë prej druri. Trupi i lahutës përbëhet nga – kasë drurit dhe qafë - doreza dhe koka. Lëkura e kafshës shtrihet përgjatë kasës në formë dardhe nga përpara, me vrima të shpuara në mes për tingull më të mirë të instrumentit. Në qafë, poshtë kokës, ka një hapje për një “çels” (tensionues), rreth së cilës shtrëngohen fijet e qimeve të bishtit të kalit. Doreza është gdhendur në të gjithë sipërfaqen në një zbukurim gjeometrik dhe mbi legen është figura e një fyelltari dhe teksti cirilik *guslar 1922*. Doreza e lahutës përfundon me figurën e një malazezi mbi kalë. Harku është prej druri, me një dorezë në formën e një dragoi. Lahuta është blerë në Budva.⁸²

foto: Lahuta
me Malazez



Lahuta Perandorët luftojnë për perandorinë

Lahuta është bërë prej druri. Trupi i lahutës përbëhet nga - kasë drurit dhe qafë - doreza dhe koka. Lëkura e kafshës shtrihet përgjatë kasës në formë dardhe nga përpara, me vrima të shpuara në mes për tingull më të mirë të instrumentit. Në qafë, poshtë kokës, ka një hapje për një “çels” (tensionues), rreth së cilës shtrëngohen fijet e qimeve të bishtit të kalit. Doreza e lahutës është e zbukuruar me oramente lulesh. Në lëkurë janë pikturuar tre figura njerëzore me grushta të shtrënguar, gati për betejë. Këta janë tre vëllezërit Mrnjaçeviq - despoti Uglesha (majtas), mbreti Vukashin (në mes) dhe duka Gojko (djathtas). Mbi të tre figurat është një mbishkrim cirilik në katër rreshta *Perandorët luftojnë për perandorinë / Duan të vrasin njëri-tjetrin / Të godasin me thika të pasurit / Por nuk e dinë se e kujt është perandoria*. Autori u dha nga një tekst secilës prej tre figurave. Kështu thotë Mbreti Vukashin: *Është e imja!* dhe despoti Uglesha dhe duka Gojko përsërisin të njëjtën shprehje: *“Jo, është e imja!”*⁸³ Legeni është i gdhendur me shkrim cirilik *Lj.P.*,



foto: Lahuta
Perandorët luftojnë
për perandorinë

⁸² Lahuta, Inventari i Muzeut Etnografik, numri i inventarit 74.

⁸³ Kjo skenë dhe teksti janë marrë nga kënga popullore *Uroshi dhe Mrnjaçeviqi*.

me një kurorë dhe shkruan viti 1926. Midis inicialeve dhe vitit ka një hapje të shpuar në formë kryqi. Pjesa tjetër e kasës është e gdhendur me zbukurime gjeometrike me ngjyra të ndryshme. Pjesa e sipërme e dorezës përfundon në formën e kokës së dhisë. Harku është bërë në formë të lakuar. Lahuta është bërë nga Lubo Pllamenac nga fshati Bolevici (Crmnica) në vitin 1926.⁸⁴

Lahuta socialiste

Lahuta është bërë prej druri. Trupi i lahutës përbëhet nga - kasë drurit dhe qafë - doreza dhe koka. Lëkura e kafshës shtrihet përgjatë kasës në formë dardhe nga përpara, me vrima të shpuara në mes për tingull më të mirë të instrumentit. Në qafë, poshtë kokës, ka një hapje për një “çels” (tensionues), rreth së cilës shtrëngohen fijet.

Doreza është zbukuruar me zbukurime gjeometrike dhe bimore të gdhendura. Mbi të, në pjesën e poshtme, ka dy medaljone rrethore - njëra me dy yje pesëcepësh dhe tjetra me imazhin e Njegoshit. Në pjesën e sipërme të dorezës ka tetë medaljone, në të cilat është figura e Josip Broz Titos (në mes) i rrethuar nga krahët e Jugosllavisë (në krye) dhe të gjashtë republikave. Rreth këtij motivi janë dy kurora, të cilat mbahen nga duart. Në krye, ishte një yll me pesë cepa me një çekiç dhe drapër. Në anën e pasme të lahutës, në medaljonin qendror është mbishkrimi cirilik *Tito* i rrethuar me dy kurora dhe slogani *Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni*. Gjashtë medaljone janë lyer me ngjyrat e flamujve të Republikës Jugosllave, dhe e teta (më e madhja) ka flamurin jugosllav. Medaljonet janë gjithashtu të rrethuara me dy kurora, dhe në pjesën e sipërme ka një pentakle të kuqe, por pa çekiç dhe drapër. Në të majtë dhe në të djathtë të dorezës (në të dyja anët) janë dy trengjyrëshe jugosllave. Harta e Jugosllavisë është vizatuar në kasë. Dekorimi shtesë në lahutë janë dy zinxhirë prej druri. Harku është bërë në formën e gjarpurit. Lahuta është blerë në Cetinë.⁸⁵



foto:
Lahuta socialiste



foto:
Fylli me lëkurë

Fylli me lëkurë

Fylli përbëhet nga dy pjesë - pjesa e poshtme është bërë nga lëkura e qengjit, dhe tubi i sipërm është prej druri. Vetë tubi përbëhet nga dy pjesë, të bëra nga dy lloje të ndryshme druri. Pjesa e poshtme është më e gjerë dhe mbulohet me

⁸⁴ Lahuta, Inventari i Muzeut Etnografik, numri i inventarit 74.

⁸⁵ Lahuta, Inventari i Muzeut Etnografik, numri i inventarit 82.

lëkurë, dhe pjesa e sipërme, në të cilën fryhet, është më e ngushtë dhe ka 12 vrima për gishta (gjashtë rreshta nga dy). Në njërin pjesë të lëkurës është futur një fryes ajri prej druri, 7 cm i gjatë. E gjithë sipërfaqja e fyellit është e zbukuruar në mënyrë të pasur me zbukurime të imta gjeometrike dhe ornamente bimore të gdhendura dhe me një paraqitje të një figure mashkullore.⁸⁶

Zumarja

Fyelli - zumarja është bërë nga dy lloje materialesh, metali dhe kocka e bririt. Pjesa metalike përbëhet nga dy tuba metalikë që lidhen në pjesën e sipërme dhe të poshtme me tel dhe të mbushura me katran. Pjesa e dytë është prej kocke në formë trumbete, me buzë të dhëmbëzuara. Në pjesën e sipërme në të cilën fryhet ka 10 vrima gishtash (pesë rreshta nga dy). Fyellit u blenë në Krajë në Liqenin e Shkodrës.⁸⁷

foto:
Zumarja



Duduku

Duduku është prej kallamit, në formë cilindrike. Në pjesën e sipërme, në të cilën fryhet ka një hapje, dhe në pjesën e poshtme ka pesë vrima për gishta. Është zbukuruar me ornamente gjeometrike të pikturuara. Duduku u ble në Guci.⁸⁸



foto:
Duduku



⁸⁶ Fyellit me lëkurë, Inventari i Muzeut Etnografik, numri i inventarit 83.

⁸⁷ Zumarja, Inventari i Muzeut Etnografik, numri i inventarit 101.

⁸⁸ Duduku, Inventari i Muzeut Etnografik, numri i inventarit 103.

Tregtia

Qytetet bregdetare të Malit të Zi, të cilat dalin në detin Adriatik, kanë marrë pjesë aktive në tregtinë mesdhetare për gati dy mijëvjeçarë e gjysmë. Nga emporiumi në Budva nëpërmjet Risanit, Kotorrit, Tivarit, Ulqinit dhe, para fundit të Mesjetës, Herceg Novit, ka ndalesa të pashmangshme në shkëmbimin e mallrave midis Mesdheut dhe brendësisë së Ballkanit. Me zhvillimin e tregtisë vërehet ndërveprim ndërmjet kulturave të ndryshme, gjë që e pasuroi edhe më shumë multikulturalizmin e Malit të Zi. Në territorin e tij u gjetën objekte të shumta që dëshmojnë për lidhje tregtare me pjesë të tjera të botës së njohur dhe disa prej tyre ruhen në Muzeun Kombëtar.

Aureus romak

Aureusi i artë romak (lat. *aurei* – i artë) i periudhës së mbretërimit të Neronit (54 – 68) është farkëtuar midis viteve 66 dhe 67 pas Krishtit. Me peshë është rreth 7.2 gram dhe për një aureus mund të fitohej 25 denarë (monedha argjendi). Ana e përparme tregon kokën kthyer djathtas të perandorit Neron me një kurorë dafine. Koka është e rrethuar me mbishkrimin latin IMP NERO CAESAR AVGVSTVS (lat. *Imperator Nero Caesar Augustus* – Perandori Nero Caesar Augustus). Ana e pasme tregon perëndinë supremë romak Jupiterin të ulur në fron dhe të veshur me një tunikë të gjatë. Në dorën e djathtë mban një rrufe dhe në të majtën një shtizë. Në të djathtë të tij qëndron mbishkrimi CVSTOS (lat. *custos* – roje), ndërsa në të majtë të tij dallohen vetëm pjesë të mbishkrimit IVPPITER (lat. *Iuppiter* – Jupiter). Monedha është farkëtuar në Romë dhe është shumë e rrallë dhe e vlefshme sot.⁸⁹



foto:
a. Aureus romak, pjesa e përparme i
b. Aureus romak, ana e pasme




foto:
Figura e
perëndeshës
egjiptiane

Figura e perëndeshës egjiptiane

Figura prej bronzi 12 cm e gjatë, që përfaqëson perëndeshën Sekhmet, e paraqitur me kokën e luanit dhe trupin e gruas. Mbi kokë është një disk diellor nga i cili varet një kobër. Duart janë ngjitur në trup dhe e gjithë figura është në pedestal me fidan. Në mitologjinë egjiptiane, Sekhmet është e bija e perëndisë Ra dhe konsiderohet të jetë një manifestim hakmarrës i fuqisë së Ra. Ajo konsiderohej gjithashtu një perëndeshë e luftës, mjekësisë, si dhe e hyjnisë diellore. Prania e këtij objekti flet për lidhjen mes qyteteve të bregdetit malazez dhe pjesëve të tjera të Perandorisë Romake.⁹⁰

⁸⁹ Monedha ndodhet në Muzeun Historik.

⁹⁰ Figura bronzi, Inventari i Muzeut Arkeologjik..

Amfora dhe shishja

Amfora në formë elipsoide me qafë të gjatë cilindrike dhe dy doreza vertikale, të pozicionuara anash, është bërë nga dheu i kuq i pjekur. Dorezat janë të dëmtuara. Kur u gjet amfora mungonte pjesa e poshtme konike. Falë trajtimit konservues, amfora u trajtua për të përmirësuar pamjen dhe gjendjen e saj dhe restaurimi tregoi formën e vërtetë të kësaj qeramike. Amfora është 87 cm e gjatë dhe u gjet në nekropolin e Budvës në vitin 1938. Kjo lloj amfore përdorej për transportimin e lëngjeve, kryesisht verës, vajit e ullirit, kripës, garuma (lloj salce e bërë nga peshku)... Ndodhte që arkeologët të gjenin amfora të mbyllura, të cilat ende përmbanin verë ose vaj ulliri.⁹¹ Shishe qelqi me mure të trasha, me formë cilindrike. Ka një qafë të gjatë të ngushtë dhe dy doreza masive me shirit të profilizuar. Sipërfaqja e shishes është e zbukuruar me vija të incizuara sipër të cilave ka brazda të zhdrejta të incizuara dhe poshtë saj janë prerje eliptike. Shishja u gjet në Risan gjatë gërmimeve të mozaikut në vitin 1931-1932. vjet. Gjatësia e saj është 24 cm. Romakët ishin mjeshtër të prodhimit të produkteve të qelqit, gjë që mund të shihet në këtë artikull. Shishe e këtyre përmasave përdorej për transportin dhe ruajtjen e produkteve kozmetike (vajra esencialë, pomada, parfume...).⁹²




foto:
a. Amfora i
b. Shishe qelqi

Dinari i mbretit Dragutin

Dinar argjendi i mbretit serb nga dinastia Nemanjiq, Stefan Dragutin, i farkëtuar gjatë mbretërimit të tij në 1276-1282 vit. Monedha vjen nga Brskov afër Mojkovacit, një minierë e famshme argjendi mesjetare. Në anën e përparme të monedhës është imazhi i Shën Stefanit, duke i dorëzuar flamurin Dragutinit. Në të majtë dhe në të djathtë të figurës qëndron mbishkrimi latin S STEFAN REX STEFAN, që në përkthim do të thotë *Shën Stefani, Mbreti Stefan*. Në anën e pasme, ka një figurë të Jezu Krishtit përballë shikuesit. Krishti gjendet ulur në fron dhe mban ungjillin. Në anën e majtë dhe të djathtë të kokës së Jezusit është mbishkrimi IC XC (greqisht: *Ἰησοῦς Χριστός*). Pësja e monedhës është 2.12 gram, dhe diametri është 21 mm.⁹³



foto:
a. Dinar argjendi, ana e përparme i
b. Dinar argjendi, ana e pasme

⁹¹ Amfora, Inventari i Muzeut Shtetëror, numri i inventarit 137.

⁹² Shishja, Inventari i Muzeut Shtetëror, numri i inventarit 78.

⁹³ Monedha ndodhet në Muzeun Historik.

Solid venecian

Monedhë standarde bakri veneciane me vlerë dy solide. Është farkëtuar midis vitit 1691 dhe 1709. Peshon rreth 7 g, dhe diametri është 28 mm. Ana e përparme tregon luanin me krahë, simbol i Republikës së Venedikut dhe mbrojtësin e saj Shën Markun. Sipër është një mbishkrim në latinisht SAN·MARC·VEN (lat. *Sancus Marcus Venet* – Shën Marku i Venedikut). Poshtë luanit është një vijë, që e ndan atë nga emërtimi. Emërtimi është i shkruar me numrin romak II dhe gjendet midis dy luleve. Në anën e pasme ka dy lule, një sipër, një poshtë, midis të cilave ka një mbishkrim latin në tre rreshta DALMA / E · T / ALBAN (lat. *Dalmatia et Albania* – Dalmacia dhe Shqipëria). Kjo seri monedhash përdorej në *Stato da Mar* (Shteti i Detit), pra në zotërimet veneciane në Dalmaci dhe Shqipëri. Kjo monedhë është shumë e zakonshme, gjë që flet për tregtinë e gjallë mes këtyre anëve dhe Venedikut.⁹⁴



foto:
a. Solid venecian, pjesa e përparme i
b. Solid venecian, ana e pasme

Kurus i artë osman

Monedhë osmane e artë nga mbretërimi i Sulltan Abdul Azizit (1861-1876). Në mes të pjesës së përparme është tugra (vula) e sulltanit. Mbi tigrin janë shtatë yje me pesë cepa, dhe poshtë një kurorë dafine. Midis tigrës dhe kurorës së dafinës është viti i farkëtimit i treguar si numri 2⁹⁵, i cili përfaqëson vitin 1862, pra vitin e dytë të mbretërimit të Sulltan Abdul Azizit. Në anën e pasme, në mes, ka një mbishkrim arabisht në gjuhën turke *Le të jetë fitues*. Farkëtuar në Kostandinopojë në 1277⁹⁶. Numri 1277 përfaqëson vitin 1861 sipas Hixhretit, pra vitin kur në fron hipi Sulltan Abdul Azizi. Mbishkrimi dhe viti janë të rrethuar me një kurorë dafine, ndërsa në krye është një yll me pesë cepa. Pësja e monedhës është 3,61 g, dhe diametri është 15 mm.⁹⁷



foto:

a. Kurus osman, pjesa e përparme i
b. Kurus osman, ana e pasme



⁹⁴ Njësoj.

⁹⁵ Numri është i shkruar me shifrën që është numri arab lindor për numrin 2.

⁹⁶ Numri është i shkruar me shifrën ١٢٧٧ që është numri arab lindor për numrin 1277.

⁹⁷ Monedha ndodhet në Muzeun Historik.

Multikulturalizmi në antikitet

Multikulturalizmi nuk është karakteristikë vetëm e shoqërisë moderne malazeze. Fillimet e tij mund të gjurmohen në shekullin e V para erës sonë, kur grekët krijuan një emporium (qytet-treg) në territorin e Budvës së sotme, dhe kështu vendosën kontakte me fiset ilire në brendësi. Për shekuj me radhë, grekët dhe ilirët jetuan njëri pranë tjetrit, duke shijuar benefitet e tregtisë. Në mesin e shekullit II p.e.s. vijnë romakët, si kombi i tretë që do të vendoset në territorin e Malit të Zi të sotëm. Të tre popujt lanë pas gjurmët e qytetërimit të tyre, i cili sot përfaqëson thesarin e paçmuar kulturor të Malit të Zi.

Sëpata

Një sëpatë bronzë që i përket tipit shqiptaro-dalmat. Sëpata ka fole të shpuara horizontalisht, teh fort të lakuar dhe një gjemb qartësisht të dukshëm në pjesën e poshtme të tehut. Në pjesën e jashtme të dorezës janë të spikatura brinjë plastike shumë më të vrazhda, ndërsa tehu i lartpërmendur është shumë më pak i theksuar në këto sëpata. Ky lloj sëpate lidhet kryesisht me bregun e Adriatikut dhe brendësinë e tij dhe shfaqet për herë të parë rreth vitit 1500 para Krishtit, në fillimin e epokës së bronzit.⁹⁸



foto:
Sëpata bronzë e tipit
shqiptaro-dalmat

Përkrenarja greko-ilire

Ky lloj përkrenarje bronzë është syunar për luftimin e ushtarëve të armatosur lehtë (këmbësorëve) dhe ishte privilegj i një numri të kufizuar luftëtarësh që mund t'i blenin ose t'i fitojnë. Ishte e farkëtuar nga një copë bronzë e vetme. Pjesa e sipërme e përkrenarës është e përforcuar me dy "brinjë" strukturore të spikatura të destinuara për të thithur goditjet e shpatës dhe për të drejtuar gjatësinë e përkrenarës, ndërsa pjesa e pasme e përkrenarës shërbente si mbrojtëse e qafës. Nga ana e përparme, hapja për fytyrën është katrore, e karakterizuar nga mungesa e një mbrojtëse të hundës dhe pllakës fikse të faqeve. Skajet e përkrenarës janë zbukuruar me një model delikat pikash të ngritura midis dy vijave, të paraqitura si relief. Në pjesën e sipërme të ballit ka një shtojcë që përdorej për të fiskuar stemën, ndërsa në anën e pasme të përkrenarës gjendet alka, i cili përdorej për të vendosur një shtëllungë mbi të. Është interesante se përkrenaret tjera të këtij lloji të gjetura në Mal të Zi nuk e kanë këtë lloj alke. Përkrenarja greko-ilire e ka origjinën nga Greqia veriore, prej nga u përhap në të gjithë Ballkanin, ndër ilirët. Përkrenarja përfaqëson daton nga shekulli IV ose V para Krishtit.⁹⁹



foto:
Përkrenarja greko-ilire

⁹⁸ Sëpata, Inventari i Muzeut Arkeologjik.

⁹⁹ Helmeti greko-ilir, Inventari i Muzeut Arkeologjik.

Shpata ilire

Shpata është prej bronzi dhe është 80 cm e gjatë. Është ruajtur vetëm pjesa metalike e dorezës së shkurtër dhe nuk dihet se me çfarë ishte e mbuluar doreza. Mbi dorezën është një kryq gjysmërrethor (parakolp dore), i cili duhej të mbronte dorën nga tehu i kundërshtarit. Në kryqëzim ka dy vrima rrethore midis të cilave ka një brazdë. Tehu është 65 cm i gjatë, dhe maja është e mprehtë, rreth 15 cm e gjatë. Tehu përdorej me një rën dorë, ndërsa mburoja në dorën tjetër. Për shkak të gjatësisë së saj, ajo ishte menduar për luftime të afërta, duke qenë të përmasave të ngjashme me *gladiusin* romak.¹⁰⁰



foto: Shpata ilire

Llambë helenistike në formën e këmbës së njeriut

Llamba (zhizhak) është përbërë nga dheu i pjekur i verdhë. Llamba është në formën e këmbës së njeriut. Këmba është paraqitur e veshur me sandale me rripa, e mbështetur në pedestal të sheshtë drejtkëndor.¹⁰¹ Në anën e pasme, mbi thembë është një, ndërsa në disk janë shtatë vrima të renditura në mënyrë rrethore. Ky model llambë lidhet me kultin Isis. Konsiderohet se sjellin fat dhe kur gjenden në varr kanë një funksion apotropaik (për të larguar shpirtrat e këqij). Për këtë lloj llambë u bë një kallëp i veçantë, i cili duhej thyer pas pjekjes, gjë që rriti çmimin e saj.



foto:
Llambë helenistike në
formën e këmbës së njeriut

Kub romak

Kubi është bërë nga kocka. Anët e kubit janë të shënuara me gropa të vogla, të cilat kufizohen nga një rreth të prerë. Numri i rrethëve në anë shkon nga një në gjashtë. Edhe pse bixhozia ishte e ndaluar, romakëve u pëlqente të luanin bixhoz, veçanërisht anëtarëve të shtresave të ulëta shoqërore dhe ushtarëve.¹⁰²



foto:
Kub romak

¹⁰⁰ Shpata ilire, Inventari i Muzeut Arkeologjik.

¹⁰¹ Zhizhak, Inventari i Muzeut Shtetëror, numri i inventarit 41.

¹⁰² Kubi, Inventari i Muzeut Arkeologjik.

Pllakë romake

Pllakë reliev në formë drejtkëndëshe, përmasat 9 x 15 cm. Është bërë nga toka e thatë e pjekur, dhe është e veshur me firnis të zezë për mbrojtje. Pllaka përshkruan perandorin në triumf.¹⁰³ Ai është i hipur në karrocë dhe me dorën e djathtë përshëndet ushtarët dhe qytetarët e mbledhur. Në plan të parë, përveç perandorit, dallohen katër figura, ndërsa në sfond shihen ushtarët, kuajt dhe armët. Në të djathtën e perandorit, shumë afër kokës, gjendet figurë njerëzore me krahë, *gjeniu i fitores*. Supozimi është se skena simbolizon zakonin e *memento mori* (kujtohu që je i vdekshëm), i cili dikur praktikohet gjatë ceremonisë triumfale.



foto:
Pllakë romake

Fibula e artë

Fibula është në formë kryqi, pa gjilpërë dhe me hark të shkurtër të ngritur. Fillimi i harkut është futur në mes të krahut tërthor të kryqit, i cili përfundon me dekorime më të mëdha konike, të ndara nga harku me voluta, pjesa më e lartë e të cilit fillon nga harku. Zbukurimet ndahen nga voluta me copa teli të përdredhur të aplikuara rreth krahëve të kryqit. Dekorimi konik i përparmë aplikohet në fillimin e harkut, nga i cili ndahet me një copë teli të përdredhur. Profili i harkut është në formën e një trekëndëshi të rrethuar me anën e ngushtë lart. Pjesa e pasme e saj është e ngulitur në këmbën e fibulës, nga e cila ndahet edhe me një copë teli të përdredhur, të mbështjellë rreth harkut. Këmba e fibulës është e njëjtë me gjerësinë e bazës së harkut. Sipërfaqja më e ngushtë e sipërme, e harkut është e mbuluar me zbukurime të stilizuara, të çekanit, në formën e numrit arab 3 duke formuar një brez dekorativ, i cili shtrihet në pjesën qendrore të këmbës së fibulës. Ky brez i zbukuruar ndahet me vija të prera nga skaji i jashtëm i harkut dhe zbukurohet në formën e një germe latine të shtypur G, nga të cilat janë katër në secilën anë të brezit, në këmbën e fibulës. Këmba e fibulës është e prerë në mënyrë të pjerrët dhe e zbukuruar me një zbukurim bimor. Fibula është gjetur në Dukljë dhe vlerësohet të jetë nga fundi i shekullit III dhe fillimit të shekullit të IV pas Krishtit. Gjatësia totale e saj është 8.2 cm.¹⁰⁴




foto:
Fibula e artë

Fibulat përdoren si kapëse për fiksimin e rrobave. Fibulat e arit janë shumë të rralla dhe vetëm klasat më të pasura të shoqërisë mund t'i kishin ato.

¹⁰³ Pllakë e relievit, Inventari i Muzeut Shtetëror, numri i inventarit 65.

¹⁰⁴ Fibula e artë, Inventari i Muzeut Shtetëror, numri i inventarit 138.

Multikulturalizmi i Principatës së Malit të Zi

Principata e Malit të Zi ishte një fenomen unik në Ballkan në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX. Nga një principatë njëetnike, njëfetare dhe njëgjuhëshe para Luftës së Madhe, pas fitimit të pavarësisë, u shndërrua në një bashkësi multietnike, multikulturore dhe shumëgjuhëshe. Falë politikës vizionare të princit Nikolla Petroviq - Njegosh, nuk pati emigrim të detyruar të popullsisë pakicë, por autoritetet u përpoqën t'i integronin në shoqërinë malazeze. Suksesi i asaj politike e dëshmon edhe fakti se sot në Mal të Zi minoritetet ende jetojnë në zonat e çliruara në vitin 1878, ndryshe nga zonat që u bashkuan shteteve të tjera ballkanike me Traktatin e Berlinit. Muzeu Kombëtar përmban shumë materiale që dëshmojnë për multikulturalizmin në periudhën 1878-1912.

Nenet e Traktatit të Berlinit që garantojnë të drejta dhe liri për të gjithë besimtarët në Mal të Zi¹⁰⁵

Neni 27.

Palët e Larta Kontraktuese bien dakord për dispozitat në vazhdim: në Mal të Zi, dallimet në fe dhe besim nuk do të jenë pengesë për dikë që të përjashtohet ose të pengohet të gëzojë të drejtat e tyre civile dhe politike, të pranohet në shërbime publike, poste dhe të mos i jepen nderime apo zanate dhe profesione të ndryshme, kudo që të jetë. Liria dhe kryerja publike e të gjitha riteve fetare do t'u sigurohet të gjithë banorëve të Malit të Zi, si dhe të huajve, dhe nuk do të lejohet asnjë pengesë as për organizimin hierarkik të feve të ndryshme, as për marrëdhëniet e tyre me prijësit e tyre shpirtërorë.

Neni 30.

Myslimanët ose pronarët e tjerë të pronave në zonat e aneksuara në Mal të Zi, të cilët vendosin të jetojnë jashtë kufijve të Principatës, do të mund t'i mbajnë pronat e tyre duke i dhënë me qira ose duke i menaxhuar ato përmes palëve të treta. Askujt nuk do t'i konfiskohet pasuria, përveç nëpërmjet proceseve gjyqësore në interes të shtetit dhe me pagesën e kompensimit paraprak. Komisioni turko-malazez do të ketë për detyrë të zgjidhë brenda tre vjetëve në emër të Portës së Lartë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me tjetërsimin, përdorimin dhe shfrytëzimin e pronave shtetërore dhe të fondacioneve fetare (vakëfeve), si dhe çështje të tjera që lidhen me interesat e individëve.

105 Me Traktatin e Berlinit më 13 korrik 1878, Mali i Zi u njoh si shtet i pavarur nga fuqitë e mëdha që nuk e kishin bërë këtë deri atëherë. Nenet 26-33 kanë të bëjnë me Malin e Zi. Biblioteka - departamenti i arkivit, numri i inventarit B-IV-1432.

SHPALLJE
POPULLIT NË PODGORICË DHE ZETË.

POUPULL!

Kur u munduan për t'i dhënë fund luftës së gjatë, të vështirë dhe të përgjakshme, e cila shkaktoi aq shumë dhimbje dhe sakrifica për të gjithë ne, fuqitë e mëdha evropiane vendosën që Podgorica dhe Zeta t'i bashkohen PRINCIPATËS SË MALIT TË ZI.

Ky bashkim, i cili u fitua nga gjaku i shumtë e i çmuar i popullit Tim dhe i konfirmuar nga favori i fuqive evropiane, u krye sot sipas marrëveshjes Sime të mëparshme me Madhërinë e Tij Sulltanin.

Nga ky moment ju jeni qytetarë të lirë të Malit të Zi dhe gjykatat dhe të gjitha autoritetet e Mia marrin jetë në vendet tuaja.

Popull! Ushtria ime, e cila sot zëvendësoi ekuipazhin e dikurshëm perandorak, vjen te ju, te vëllezëret e vet, me dashuri dhe entuziazëm vëllazëror. Detyra e saj do të jetë gjithmonë të ruajë qetësinë dhe rendin për ne, në të cilin ju do të keni rehatinë më të mirë dhe, me ndihmën e Zotit, në dobinë tuaj, të merreni përsëri me punën tuaj, në mënyrë që mirëqenia juaj të lulëzojë. Tregjet dhe rrugët janë të hapura sot dhe secili është i lirë dhe i sigurt në to për veten dhe pronën e tij, si në shtëpinë e tij.

Muhamedanë! Juve, feja nuk do ju ndajë nga bashkëqytetarët tuaj ortodoksë dhe katolikë. Të gjithë së bashku do të gëzoni të njëjtën dashuri timen, të njëjtën drejtësi të ligjeve të Mia. Secili është i lirë në fenë e tij, në zakonet e tij të mira, në punën e tij.

Popull! Shkoni në punë tani, jini të ndëgjueshëm dhe të bindur ndaj autoriteteve tuaja, jetoni në paqe dhe dashuri në shtëpi dhe në fqinjësi, dhe bekimi i Zotit do të jetë mbi ju dhe do të jeni të kënaqur dhe të pasur, të lirë dhe të lumtur.


Në Cetinë me 26. janar 1897.

PRINC NIKOLLA

¹⁰⁶ Departamenti i Bibliotekës dhe Arkivit, *Inaugurimi*, Zëri i Malazezëve, 27 janar 1879, nr. 3, fq. 1.

Telegrami i Dukës Simo Popoviq për Dukën Masho Vrbica në lidhje me flamurin tregtar detar¹⁰⁷

Flamuri ynë detar duhet të konsiderohet shumë seriozisht. Është krejt e natyrshme që Turqit e kanë të vështirë ta mbajnë kryqin lart mbi kokë. Nëse i detyrojmë ta bëjnë këtë, Turqit dhe të tjerët, mund të shpërngulen shumë lehtë. Përkundrazi, nëse e ndërrojmë flamurin, bota e huaj do të na lavdërojë se jemi të drejtë ndaj ndjenjave fetare të nënshtetasve tanë dhe me këtë do të fitojmë plotësisht dhe do të përmbushim pritjet e të gjithëve. Mund ta mbajmë kryqin në flamur, por besoni se më pas do ta humbasim këtë flotë, e cila do të jetë një mjet i pasur i tregtisë sonë dhe do ta përhapë emrin malazez në mbarë botën. Dje kuptova se Turqisë nuk i intereson aq shpërngulja e ulqinakëve, sa shpërngulja e kapitenëve dhe anijeve të tyre, dhe të ndërtojnë një qytet të ri detar në anën tjetër të Bunës në San Gjovani. Flamuri ynë kryqtar do t'i ngrejë, që përndryshe asnjë forcë nuk do t'i ngrinte. Ulqini me anije ka rëndësi të madhe, por pa anije jo. Mos e humbisni për inat të thjeshtë. Nesër do t'ju shkruaj më shumë për këtë, e kam për detyrë t'ju lajmëroj shpejt.¹⁰⁸



a.



b.



foto

a: Flamuri detar me kryq;

b: Flamuri detar me inicialet e Princ Nikollës

107 Pas fitimit të Tivarit dhe daljes në detin Adriatik, ishte e nevojshme që Mali i Zi të merrte flamurin e tij detar dhe tregtar. Zgjidhja e parë ishte një flamur kuq-blu-bardhë, me një kryq maltez në këndin e sipërm majtas, i cili u përdor për disa muaj dhe nuk ka mbetur asnjë kopje. Pas hyrjes së ushtrisë malazeze në Ulqin (26 XI 1880), u zëvendësua nga një trengjyrësh i ri kuq-blu-bardhë me një kryq të madh në këndin e sipërm të majtë. Kryqi në bregdetin multi-etnik ngacmoi popullsinë vendase, gjë që çoi në protesta nga detarët e besimit islam tek autoritetet malazeze. Prandaj duka Simo Popoviq, guvernatori i Bregdetit i shkruan këtë telegram dukës Masha Vrbica, ministrit të punëve të brendshme. Propozimi u pranua dhe u miratua një flamur i ri detar. Ishte një trengjyrësh kuq-blu-bardhë me inicialet *N. I.* (Nikolla i Parë) dhe një kurorë sipër. M. Joviqeviq, *Emblemat shtetërore dhe dinastike malazeze*, Cetinë 2001, fq. 130-136.

108 kap. D. Franetoviq, *Historia e detarisë dhe peshkimit të Malit të Zi deri në vitin 1918*, Titograd 1960, fq. 279.

Konkordati midis Vatikanit dhe Principatës së Malit të Zi nga viti 1886 ¹⁰⁹

Neni 1.

Feja katolike, apostolike, romake do të praktikohet lirisht dhe publikisht në Mal të Zi.

Neni 4.

Përpara marrjes së detyrës, kryepeshkopi i Tivarit do të bëjë betimin për besnikëri përpara Madhërisë së Tij Princ Nikollës me fjalët e mëposhtme: “Betohem dhe premtoj përpara Zotit dhe Ungjillit të Shenjtë se do t’i bindem dhe do t’i jem besnik M. T. Princit të Malit të Zi; Premtoj se nuk do të bëj asnjë marrëveshje, nuk do të realizoj asnjë synim, as nuk do të marr pjesë apo lejoj pjesëmarrjen e popullsisë në varësinë time në asnjë ndërmarrje që mund të prishte qetësinë publike në shtet”. - Qeveria malazeze e njeh kryepeshkopin Monsinjon të Shenjtë dhe i jep të ardhura vjetore prej 5000 frangash.

Neni 7.

Në famullitë ku nuk ka kishë katolike, kryepeshkopi do të merret vesht me autoritetet lokale që, nëse është e mundur, t’i kushtohet një ndërtesë e përshtatshme.

Neni 8.

Bazuar në funksionin priftëror, kryepeshkopi drejton edukimin fetar të të rinjve katolikë në të gjitha shkollat dhe cakton, në marrëveshje me qeverinë, një prift ose mësues katolik për edukimin fetar të të rinjve katolik në shkollat publike. Ai mësues do të ketë të njëjtën pagë si mësuesit e tjerë. Kur bëhet fjalë për lokalitete me popullsi vetëm katolike ose ku katolikët janë shumicë, qeveria do të zgjedhë personat e miratuar nga autoriteti i kishës për shkollat publike.

Neni 9.

Qeveria njeh vlefshmërinë e martesave ndërmjet katolikëve dhe martesave të përziera të lidhura në prani të priftit katolik, sipas ligjeve të Kishës.

Neni 10.

Formula e lutjes për sundimtarin: *Domine, salvum fac Principem*, do të këndohet në shërbesat hyjnore në gjuhën sllave.



foto
Konkordati midis Vatikanit dhe Principatës së Malit të Zi

109 Konkordati prej 14 neneve midis Vatikanit dhe Principatës së Malit të Zi ishte konkordati i parë i nënshkruar midis Vatikanit dhe një vendi me shumicë ortodokse. Kjo kontratë përcaktonte të drejtat dhe detyrimet e klerit katolik dhe besimtarëve të tyre. Kontrata është nënshkruar para Vatikanit nga kardinali L. Jakobini, ndërsa nga Mali i Zi nga Jovan Sundeçiq. Konkordati origjinal është në pronësi të Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivave.

Foto *Para dyqanit*

Fotoja tregon tre figura meshkujsh, një në rrugë para dhe dy në një dyqan me një hapje që ka dy roleta ngjyrë ulliri. Figura e djalit me veshjen kombëtare malazeze, e vendosur majtas dhe me shpinë nga shikuesi, është dhënë në kontraposto, me krahun e majtë të përkulur dhe dorën e djathtë duke mbajtur një cigare. Dy figura, në sfond (djathtas), përbëjnë grupin që në mënyrë kompozicionale mban një ekuilibër me figurën në plan të parë. Figura e përparme (në fakt bust) është e veshur me këmbë të bardhë me një fjongo blu si element dekorimi, mban një fes të bardhë në kokë, në kontrast me flokët e zinj, gjysmë profili dhe me në të majtën është i mbështetur në skajin e dritares dhe në dorën e djathtë mban një cigare. Pas saj është një figurë në këmbë e veshur me një kostum shqiptar me fes në kokë. Dora e djathtë e figurës është e vendosur në bel, ndërsa të majtën e fsheh trupi. Ato janë të vendosur në një ambient të brendshëm që të kujton një dyqan (peshore, objekte shitjeje që nuk njihen mjaftueshëm dhe në sfond disa rreshta që supozohet se përfaqësojnë rafte me objekte shitjeje). Piktura u krijua në 1893 nga piktorja franceze Matilda D'Andlau. Është përdorur teknika vaj në pëlhurë, me përmasa 86 x 68 cm.¹¹⁰



foto
Para dyqanit, Matilda D'Andlau

Kushtetuta e Principatës së Malit të Zi për vitin 1905¹¹¹

Neni 5.

Princi Sundimtar është mbrojtësi i të gjitha besimeve fetare të pranuar në Mal të Zi.

Neni 40.

... Të gjitha fetë e tjera të njohura janë të lira në Mal të Zi.

Neni 45.

Kuvendi Kombëtar përbëhet nga deputetë të zgjedhur nga populli dhe deputetë, të cilët vijnë me pozitë, përkatësisht: Mitropoliti i Malit të Zi, Kryepeshkopi i Tivarit dhe Primati i Serbisë, Myftiu i Malit të Zi, Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Shtetëror, Kryetari i Gjykatës së Madhe, Kryetari i Kontrollit Kryesor të Shtetit dhe tre brigadirë, të cilët i emëron Princi.

¹¹⁰ Matilda D'Andlau është një piktoresh franceze që jetoi në Mal të Zi në 1893, 1908 dhe 1910. *Para dyqanit*. Inventari i Muzeut Shtetëror, muzeu i inventarit 1501.

¹¹¹ Kushtetuta e Principatës së Malit të Zi është miratuar më 06/19. 12, 1905, duke e bërë Malin e Zi vendin e fundit në Evropë që ka marrë këtë akt të madh ligjor. Bëhet fjalë për kushtetutën e përcaktuar (dhuruar) e cila kishte 222 nene. Kopja e Kushtetutës është në pronësi të Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivave.

Neni 48.

Çdo shtetas malazez i cili është në moshë madhore ka të drejtë të zgjedhë një deputet, pavarësisht se sa paguan taksa.

Neni 53.

Deputetë i popullit mund të jetë vetëm shtetasi malazez që është mbi tridhjetë vjeç, i cili jeton përgjithmonë në Mal të Zi, duke përjashtuar ata që merren me punë shtetërore, i cili gëzon të gjitha të drejtat civile dhe që i paguan shtetit të paktën 15 kruna tatimeve dhe taksave, ose në kombinim tatimet dhe taksat.

Neni 128.

Kryerja e lirë dhe publike e riteve fetare gëzohet nga të gjitha fetë e pranuar në Mal të Zi.

Neni 196.

Të gjithë nënshtetasit malazezë janë të barabartë para ligjit.

Neni 208.

Liria e ndërgjegjes është e pakufizuar.

Fetë e pranuar janë të lira dhe të mbrojtura me ligj, për sa kohë që kryerja e ritualeve të tyre nuk cenon rendin dhe moralin publik..

Kisha e Shën Antonit të Padovës në Cetinë

Cetina si kryeqyteti i Malit të Zi, fitoi gjithnjë e më shumë banorë katolikë me kalimin e kohës. Përveç qytetarëve malazezë, në qytet jetonin edhe një numër i madh diplomatësh katolikë. Ata kryenin ritet e tyre fetare si pjesë e legatës austro-hungareze, e cila kishte një kishëz të vogël brenda ndërtesës së saj. Me kalimin e kohës lindi nevoja për të ndërtuar një kishë. Donacionet për blerjen e tokës filluan të mbledheshin dhe ndër donatorët ishin edhe Princ Nikolla dhe vajza e tij Jelena e Savojës. Kështu, në vitin 1901, u ble toka prej 2276 m² dhe plani arkitektonik në frymën e neo-Romaneskës u krijua nga arkitekti italian Augusto Cesare Corradini. Banesa e famullisë u përfundua në vitin 1905, dhe kisha iu kushtua Antonit të Padovës në vitin 1912. Për mungesë fondesh, plani fillestar i Kontarinit devijoi shumë.¹¹²



foto

Kisha e Shën Antonit të Padovës

¹¹² M. Jovičević, T. Pejović, M. Lompar, *Cetinë*, Cetinë 1986, fq. 40.

Fotografitë

Një numër i madh fotografesh vizituan Malin e Zi në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX. Falë fotografive të tyre, mund të njohim lehtësisht shoqërinë malazeze në atë periudhë. Materiali është i llojlojshëm, nga fotot e anëtarëve të familjeve në pushtet, arkitekturës, peizazheve deri te popullsia. Shpesh në fotografi mund të shihet ndërveprimi midis anëtarëve të kombeve të ndryshme, gjë që dëshmon për multikulturalizmin e asaj periudhe. Muzeu Kombëtar i Malit të Zi, në fondin e tij, ka rreth 12 mijë fotografi që i përkasin kësaj periudhe dhe këtu është bërë një përzgjedhje e disa fotografive më përfaqësuese që dëshmojnë për multikulturalizëm.

a.



b.



c.



d.



foto

a. Tivari i vjetër,

b. Kisha katolike dhe pamje në Qytetin e vjetër,

c. Shqiptari në veshjen kombëtare,

d. Ulqinakët në Cetinë

Lëvizja Nacional Çlirimtare

Duke filluar nga kryengritja e trembëdhjetë korrikut në vitin 1941 deri në çlirimin përfundimtar në vitin 1945, populli i Malit të Zi mori pjesë aktive në Luftën Nacional Çlirimtare. Nën parullën *e vëllazërisë dhe bashkimit*, njësitë malazeze, së bashku me njësitë e tjera partizane jugosllave, çliruan vendin nga okupatori nazifashist dhe bashkëpunëtorët e tij. Aftësia e partizanëve për të homogjenizuar grupe të ndryshme etnike, gjuhësore dhe kombëtare ndihmoi shumë fitoren e tyre në vitin 1945 dhe krijimin e një Jugosllavie të re socialiste. Muzeu Kombëtar, si një nga pasuesit e Muzeut LNÇ të Malit të Zi, zotëron një numër të madh objektesh që dëshmojnë për multikulturalizmin e LNÇ-së.

Shpallja e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Malin e Zi, Bokën dhe Sanxhakun nga 17 tetori 1941.¹¹³

...ARNAUTËT, MUSLIMANËT, SERBET, KROATET

Krijoni ushtrinë popullore çlirimtare për të luftuar kundër pushtuesit. Bashkohuni me malazezët në luftë kundër armikut të përbashkët, për Shqipërinë e pavarur, për Sanxhakun autonom, për lirinë tuaj. Mos lejoni që tradhtarët tuaj t'ju hedhin kundër lëvizjes çlirimtare sepse mes nesh dhe Malit të Zi nuk ka çështje që nuk mund të zgjidhen në luftë të përbashkët...

Heroi kombëtar Rifat Burxhoviç Trsho (1913 - 1942)

Lindi më 11 shkurt 1913, në mes të Luftës së Parë Ballkanike, në Bijello Pole të sapoçliruar. Rrjedh nga një familje e varfër dhe në vitin e dytë të jetës mbeti jetim. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa Medresenë e Madhe "Mbreti Aleksandar I" në Shkup. Nga viti 1933 studioi në Fakultetin Juridik në Beograd, ku iu bashkua lëvizjes revolucionare të studentëve. Anëtar i PKJ-së u bë në vitin 1934 dhe nga viti 1937 ishte sekretar i Komitetit të Universitetit dhe atë pozitë e mbajti deri në vjeshtën e vitit 1939. Pas humbjes në Luftën e Prillit, ai shkoi në Bijello Pole dhe mori drejtimin e përgatitjeve për kryengritjen e armatosur. Ai vetë e udhëhoqi okupimin dhe çlirimin e vendlindjes së tij në korrik 1941. Si kryetar partie, avokoi për konsolidimin e vëllazërisë mes serbëve, myslimanëve dhe malazezëve. Me formimin e Brigadës së Tretë Sulmuese Proletare të Sanxhakut u bë zëvendëskomisar politik. Ai vdiq në luftë me çetnikët, ndërmjet 1 dhe 2 tetorit të vitit 1942, afër Qytetit Mrkonjiq. U shpall hero kombëtar me dekret të Kryesisë së AVNOJ-it më 25 shtator 1944, gjë që e bën atë një nga



Burdžević Rifat - Tršo



foto
Heroi kombëtar Rifat
Burxhoviç Trsho (1913-1942)

¹¹³ Proklamata e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Malin e Zi, Bokën dhe Sanxhak, Inventari i dokumenteve origjinale të muzeut LNÇ-së, inventari numër 77.

luftëtarët e parë që mori këtë çmim. Eshtrat e tij u transferuan në varrin e heronjve kombëtarë në Goricë.¹¹⁴

Heroi kombëtar Muharem Asoviq (1912 - 1943)

Lindi më 25 mars në vitin 1912 në Nikshiq. Para luftës ka punuar si kovaç. U bë anëtar i PKJ-së në vitin 1934. Ishtë pjesëmarrës në Luftën Nacional Çlirimtare që nga viti 1941. Kur forcat partizane u tërhoqën nga Mali i Zi në Bosnje në gjysmën e parë të vitit 1942, Asoviqi mbeti në rrethinat e Nikshiqit. Si anëtar i Komitetit të Qarkut të PKJ-së, ka kryer veprime të kundërligjshme në qytet dhe përreth. Gjatë janarit të vitit 1943, së bashku me tre bashkëluftëtarë të tjerë, në fshatin Dragovoliq u rrethua nga çetnikët. Gjatë luftës u plagos rëndë dhe për të mos u zënë rob kreu vetëvrasje. Më 10 korrik 1953, Muharem Asoviq u shpall hero kombëtar me dekret të kryetarit të RPFJ-së, Josip Broz Tito. Ai është i vetmi hero kombëtar me origjinë rome nga territori i Malit të Zi.¹¹⁵



Asoviq Muharem – Cigo

foto
Heroi kombëtar Muharem Asoviq
(1912-1943)



foto
Poster propagandistik
Rroftë Jugosllavia
Federative

Poster propagandistik Rroftë Jugosllavia Federative¹¹⁶

Posteri që feston krijimin e Jugosllavisë së re, shtet të krijuar si produkt i Luftës Nacional Çlirimtare dhe parullën *vëllazërim dhe bashkim*. Posteri tregon pesë duar që mbajnë pishtarë, që përfaqësojnë pesë kombet përbërëse të njohura në kohën e themelimit - serbët, kroatët, sllovenët, maqedonasit dhe malazezët. Pishtarët janë të bashkuar në një flakë që krijon tym në ngjyrë blu-bardhë-kuqe (trengjyrësh jugosllave) me një yll me pesë cepa në mes. Në sfond është harta e Jugosllavisë. Në të majtë të flakës është mbishkrimi cirilik *Jajce*, dhe në të djathtë është data 29 XI 1943. Posh-të krahëve është teksti cirilik: *Rroftë Jugosllavia Federale Demokratike*. Dizenjuesi i posterit është Matija Zlamalik dhe është krijuar në fund të vitit 1943, pas seancës së dytë të Këshillit Antifashist të Çlirimit Popullor të Jugosllavisë (AVNOJ) në Jajce.

¹¹⁴ O. Gjurgjeviq-Gjukiq, redaktor, *Heronjtë kombëtarë të Jugosllavisë*, Beograd 1975, fq. 125-126. Muzeu historik posedon fotografinë e Rifat Burxhoviq Trsha.

¹¹⁵ O.Gjurgjeviq-Gjukiq, redaktor, *Heronjtë kombëtarë të Jugosllavisë*, Beograd 1975, fq. 31-32. Muzeu historik posedon fotografinë e Muharem Asoviqit.

¹¹⁶ Plakat 1943, Inventari i dokumenteve origjinale të muzeut LNÇ, numri i inventarit 300.

Ekzekutimi i Gojko Krushkës dhe Musa Buta Hoxhiqit

Dy luftëtarë kundër fashizmit u varën nga pushtuesi gjerman në tregun e Balshiqit (Cetinë) më 13 janar 1944. Që nga fillimi i luftës, Gojko Krushka ka ndihmuar lëvizjen partizane dhe ka punuar si ilegal në Cetinë. U arrestua nga çetnikët më 24 dhjetor 1943. Meqë nuk rrëfeu asgjë, çetnikët ia dorëzuan gjermanëve, të cilët e dënuan me vdekje. Musa Buta Hoxhiq ishte partizan shqiptar dhe korrier i batalionit "Perlat Rexhepi". U arrestua në Podgoricë, kur u njoh nga një çetnik, i cili më parë ishte zënë rob nga partizanët shqiptarë dhe e liruan. Nga Podgorica u dërgua në Cetinë, ku iu dorëzua autoriteteve pushtuese gjermane, të cilët e dënuan me vdekje. Gojkon dhe Musën i çuan bashkë në vendgrumbullim. Sot në vendin e vdekjes së tyre gjendet një përmendore dhe eshtrat e tyre janë varrosur në Varrezat e Reja në Cetinë.¹¹⁷



foto
Gojko Krushka dhe
Musa Buta Hoxhiq para varjes



Shpallja e Kongresit të II-të të Rinisë Antifashiste të Malit të Zi dhe Bokës nga 17 dhjetor 1944¹¹⁸

...Kanë kaluar më shumë se shtatë muaj nga Kongresi i II-të i Rinisë Antifashiste të Jugosllavisë. Delegatët tanë, të zgjedhur dhe dërguar nga ju, rinia malazeze dhe e bokës, konfirmuan vëllazërinë dhe bashkimin tonë me rininë serbe e kroate, sllovene e maqedonase dhe iu betuar solemnisht Marshall Titos për luftë edhe më të ashpër kundër të gjithë armiqve, për ndërtimin e Jugosllavisë së re federale...

...U mundën ofensivat armike VI dhe VII, që donin ta hidhnin popullin tonë nën thikën dhe çizmen e tradhtarëve të bashkuar serbo-malazez, Nediqit, Lotiqit, Drazhës dhe "administratës" së shitur të Cetinës së Lubo Vuksanoviqit. Sulmet e korrikut dhe shtatorit të banditëve të Hitlerit dhe bandave të tyre fashiste çetnike dhe arnautase u mundën. Brigadat tona ishin roje besnike të fshatrave dhe qyteteve tona të lira, ku shkëlqeu jeta e re e njerëzve të lirë. Me guxim e bartën flamurin tonë të fitores nga majat e Komovës dhe Durmitorit, përtej luginës pjellore të Zetës, në Lovqenin krenar dhe Adriatikun e kaltër. Por luftëtarët tanë jo vetëm që ishin çlirimtarë të të gjithë popujve, por edhe i dhanë ndihmë vëllazërore popullit të Hercegovinës dhe Sanxhakut, i rrahën bandat gjermano-çetnike në Serbi, derdhën gjakun e tyre, së bashku me djemtë e të gjithë popujve jugosllavë, me heronjtë e Ushtrisë së Kuqe vëllazërore, në luftën për çlirimin e kryeqytetit të Jugosllavisë - Beogradit...

¹¹⁷ Gojko Krushka dhe Musa Buta Hoxhiq para varjes, Inventari i fotove LNÇ, numri i inventarit III-907.

¹¹⁸ Shpallja e Kongresit të II-të të Rinisë Antifashiste të Malit të Zi dhe Bokës, Inventari i dokumenteve origjinale të muzeut LNÇ, numri i inventarit 384.

...Ti rini, e krijove bashkimin në luftën më të përgjakshme për mbijetesën dhe lirinë. Në këto beteja të fundit ndërtoni dhe forconi më tej unitetin tuaj, në të gjitha fushat e betejës thelloni vëllazërinë dhe bashkimin tuaj me të rinjtë serbë dhe kroatë, sllovenë, maqedonas dhe myslimanë...

...Vendi ynë po çlirohet, populli ynë është shpëtuar nga skllavëria e huaj. Por vëllazërit tanë në Bosnje, Kroaci dhe Slloveni, në Istria dhe Stiria janë ende nën sulmin e armikut. Ju e drejtuat këtë luftë së bashku me ta, pa luftën e tyre edhe lufta jonë do të ishte e pasuksesshme pa Kroacinë e lirë, Slloveninë, pa Jugosllavinë e lirë nuk ka dhe nuk mund të ketë një Mal të Zi të lirë dhe të barabartë. Le të rrahin zemrat tuaja me të njëjtën dashuri për lirinë e Sarajevës, Zagrebit, Lubjanës, siç rrahin për lirinë e Cetinës dhe Beogradit. Ne ishim me...



foto
Flamuri i
Brigadës
IX malazeze

Flamuri i dorëzuar Brigadës së IX malazeze

Brigada e Nëntë malazeze u formua në Moraçen e Epërm më 1 prill 1944. U bë pjesë e Divizionit të Tretë dhe kishte rreth 1300 luftëtarë. Ajo u dallua në betejat e Bjelasicës dhe mori pjesë në çlirimin e Beranës, Andrijevicës, Rozhajes dhe Tutinit (në vjeshtë 1944). Në fillim të janarit, brigada mori pjesë në çlirimin e Sarajevës, ndërsa gjatë majit në çlirimin e Krajinës së Bosnjës dhe Kordunit. Ajo pa fundin e luftës në Slloveni.¹¹⁹ Flamuri kushtuar Brigadës IX malazeze është krijuar në Daruvar (Kroaci). Është bërë nga gratë antifashiste të atij qyteti - kroate, serbe, çeke dhe hungareze. Stema e DF Jugosllavisë, me pesë pishtarë të rrethuar me kallinj, është e qepur me dorë në sfondin e kuq. Ata pesë pishtarë, të cilët përfaqësojnë pesë kombet, së bashku formojnë një flakë, mbi të cilën ka një yll me pesë cepa. Kalli i grurit lidhet me një fjongo blu me datën 29. XI. 1943. Posh-të stemës gjendet mbishkrimi me dy rreshta floriri *Antifashistët e qytetit të Daruvarit / Brigada e IX malazeze*. Në tre anët e flamurit ka xhufka ari. Madhësia e flamurit është 90x160cm.¹²⁰

¹¹⁹ D. Brajushković, *Brigada e Nëntë malazeze*, Enciklopedi ushtarake II, Beograd 1971, fq. 420.

¹²⁰ Flamuri ndodhet në koleksionin e Muzeut Historik

Këmisha e Hasenës

Këmisha i përkiste Hasenës Terziqit, një gruaje që pa dhe ndjeu tmerret e kampeve të përqendrimit nga dora e parë. Pas kapitullimit të Italisë dhe çlirimit të Plevlës, në shtator të vitit 1943, u bashkua me Batalionin e Punës. Në dhjetor 1943, Plevla u pushtua nga forcat gjermane dhe Hasena duhej të qëndronte në qytet me dy vëllezërit e saj të mitur. Ajo u arrestua më 12 prill 1944 në Plevla nga Gestapo për shpërndarjen e materialeve politike të marra nga çeta e Plevlës. Ajo u mbajt për 45 ditë, para se të transferohej, fillimisht në Novi Pazar dhe më pas në kampin e Banjicës. Pas një muaji, ajo u deportua në kampin e përqendrimit të grave në Ravensburg në Gjermani. Falë forcës së saj, ajo punoi nën tokë për shtatë muaj në një fabrikë aeroplanësh afër Berlinit dhe në këtë mënyrë shmangu vdekjen e sigurt. U torturua nga rojet në kamp. Në një moment, së bashku me të burgosurat e tjera, u dërgua në oborrin e kampit, në temperaturë prej -20 gradë. Të burgosurat u mbajtën atje për gjashtë orë me rroba të holla. Për shkak të ardhjes së Ushtrisë së Kuqe, ajo u zhvendos në Gjermaninë veriore, ku u çlirua nga ushtarët amerikanë dhe britanikë më 4 maj 1945. Ajo qëndroi në Gjermani deri në fund të gushtit, para se të kthehej në Plevla më 4 shtator 1945.¹²¹ Këmishën ja dhuroi Muzeut Kombëtar vajza e Hasenës, Jadranka Jestroviq.



foto
Bluza e kampit e
Hasena Terziqit

¹²¹ R. Vujadinoviq, *E burgosura Hasena Terziq*, Katër korrik – faqja SUBNOR e Jugosllavisë, 27. nëntor 1979. Këmisha është në koleksionin e Muzeut Historik.

04 Struktura e orës së mësimnit

MËSUESI/JA

Filip Kuzman

NJËSIJA MËSIMORE

Shqiptarët në Principatën e Malit të Zi nga viti 1878 deri më vitin 1912

UDHËZUES KOHOR (KOHËZGJATJA E MËSIMIT)

45 min

LENDJA SHKOLLORE

Historia

KLASA

III

TEMA MËSIMORE

Mali i Zi nga viti 1851 deri në vitin 1914

SYNIMET

- Nxënësit do të mësojnë të jenë të hapur ndaj studimit të kulturave të tjera, opinioneve të ndryshme dhe paraqitjes së argumenteve;
- do të ndikojë në formimin e personalitetit të nxënësit/ses të pa ngarkuar nga intoleranca, ksenofobia, paragjykimet dhe idealet nacionaliste dhe do t'i orientojë nxënësit/et drejt kultivimit të formave demokratike të sjelljes, tolerancës fetare dhe kombëtare.

REZULTATET E MËSIMIT

- Nxënësi/ja do të jetë në gjendje të përshkruajë kushtet socio-ekonomike dhe kulturore në Mal të Zi gjatë sundimit të Princit/Mbretit Nikolla;
- nxënësi/ja do të jetë në gjendje të shpjegojë dhe vlerësojë rëndësinë e vendimeve të traktatit të paqes në Shën Stefanin dhe Kongresit të Berlinit për Malin e Zi;
- nxënësi/ja do të jetë në gjendje të shpjegojë rëndësinë e Ligjit të Përgjithshëm të Pronës dhe Kushtetutës për zhvillimin social dhe politik të Malit të Zi.

FORMAT DHE METODAT E PUNES

- Frontal, individual
- Dialogjike, monologjike, demonstrative, dokumentare

MATERIALET MËSIMORE DHE MJETET NDIHME

Prezantim në Power-Point, material audio-vizual, hartë, tekst shkollor

LITERATURA

D. Papoviq, S. Shabotiq, M. Shqeqiq, *Libri shkollor historia për klasën e tretë të shkollës së mesme*, Podgoricë 2021.

KORELACIONI

Gjeografia, Arti figurativ

Aktiviteti hyrës:

Aktiviteti i mësuesit/ës:

- bën pyetje për Kongresin e Berlinit;
- kërkon që nxënësit/et të tregojnë në hartë territoret që i janë aneksuar Malit të Zi me Traktatin e Berlinit;
- në hartë tregon zonat ku banon popullsia shqiptare.

Aktiviteti i nxënësit/es:

- Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve dhe tregojnë me gisht në hartë

Pjesa kryesore e orës:

Aktiviteti i mësuesit/ës:

- analizon nenet e Traktatit të Berlinit dhe Kushtetutës së Principatës së Malit të Zi për të drejtat e popujve pakicë (bashkangjitja nr. 1 dhe bashkangjitja nr. 2);
- tregon dy flamuj detarë dhe kërkon nga nxënësit të shpjegojnë ndryshimin (bashkangjitja nr. 3);
- shtron pyetjen - Cili flamur është ende në përdorim?, kërkon nga nxënësit/et të shpjegojnë mendimin e tyre;
- lexon telegramin e Simo Popoviqit drejtuar Masha Vrbicës dhe shpjegon rëndësinë e marinarëve shqiptarë (bashkangjitja nr. 4);
- tregon dy fotografi dhe një pikturë, analizojnë veshjet (bashkëngjitja nr. 5);
- tregon fotografinë bashkëkohore të veshjeve shqiptare (bashkangjitja nr. 6);
- tregon fotografinë e gramatikës të gjuhës shqipe të vitit 1887 dhe diskuton me nxënësit/et për rëndësinë e gjuhës për ruajtjen e identitetit kombëtar (bashkëngjitja nr. 7).

Aktiviteti i nxënësit/es:

- shënojnë;
- mendojnë dhe komentojnë;
- analizojnë materijalin që shohin.

Pjesa e fundit e orës:

Aktiviteti i mësuesit/ës:

- flet për politikën gjithëpërfshirëse të udhëhequr nga Princ Nikolla dhe jep shembuj sesi vendet e tjera të Ballkanit i trajtuan pakicat pas vitit 1878
- përgjegjet në pyetjet e nxënësve/eve.

Aktiviteti i nxënësit/es:

- bëjnë pyetje dhe flasin për njohuritë e marra.

VLERËSIMI I ARRITJEVE:

përmes përgjigjeve dhe komenteve të nxënësve/eve gjatë orës së mësimi, si dhe cilësisë së esesë (aty ku është e aplikueshme)

BASHKANGJITJET:

BASHKANGJITJA NR. 1. Nenet e Traktatit të Berlinit që garantojnë të drejta dhe liri për të gjithë besimtarët në Mal të Zi

Neni 27.

Palët e Larta Kontraktuese bien dakord për dispozitat në vazhdim: në Mal të Zi, dallimet në fe dhe besim nuk do të jenë pengesë për dikë që të përjashtohet ose të pengohet të gëzojë të drejtat e tyre civile dhe politike, të pranohet në shërbime publike, poste dhe të mos i jepen nderime apo zanate dhe profesione të ndryshme, kudo që të jetë. Liria dhe kryerja publike e të gjitha riteve fetare do t'u sigurohet të gjithë banorëve të Malit të Zi, si dhe të huajve, dhe nuk do të lejohet asnjë pengesë as për organizimin hierarkik të feve të ndryshme, as për marrëdhëniet e tyre me prijësit e tyre shpirtërorë.

Neni 30.

Myslimanët ose pronarët e tjerë të pronave në zonat e aneksuara në Mal të Zi, të cilët vendosin të jetojnë jashtë kufijve të Principatës, do të mund t'i mbajnë pronat e tyre duke i dhënë me qira ose duke i menaxhuar ato përmes palëve të treta. Askujt nuk do t'i konfiskohet pasuria, përveç nëpërmjet proceseve gjyqësore në interes të shtetit dhe me pagesën e kompensimit paraprak. Komisioni turko-malazez do të ketë për detyrë të zgjidhë brenda tre vjetëve në emër të Portës së Lartë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me tjetërsimin, përdorimin dhe shfrytëzimin e pronave shtetërore dhe të fondacioneve fetare (vakëfeve), si dhe çështje të tjera që lidhen me interesat e individëve.

BASHKANGJITJA NR. 2. Nenet e Kushtetutës së Principatës së Malit të Zi lidhur me të drejtat e pakicave

Neni 5.

Princi Sundimtar është mbrojtësi i të gjitha besimeve fetare të pranuar në Mal të Zi.

Neni 40.

... Të gjitha fetë e tjera të njohura janë të lira në Mal të Zi.

Neni 128.

Kryerja e lirë dhe publike e riteve fetare gëzohet nga të gjitha fetë e pranuara në Mal të Zi.

Neni 208.

Liria e ndërgjegjes është e pakufizuar.

Fetë e pranuara janë të lira dhe të mbrojtura me ligj, për sa kohë që kryerja e ritualeve të tyre nuk cenon rendin dhe moralin publik.

BASHKANGJITJA NR. 3. Dy flamuj detarë




 foto
Flamuri detar me kryq




 foto
Flamuri Detar me inicialet e Princ Nikollës

BASHKANGJITJA NR. 4. Telegrami i Dukës Simo Popoviq për Dukën Masha Vrbica në lidhje me flamurin tregtar detar

Flamuri ynë detar duhet të konsiderohet shumë seriozisht. Është krejt e natyrshme që Turqit e kanë të vështirë ta mbajnë kryqin lart mbi kokë. Nëse i detyrojmë ta bëjnë këtë, Turqit dhe të tjerët, ata mund të shpërngulen shumë lehtë. Përkundrazi, nëse e ndërrojmë flamurin, bota e huaj do të na lavdërojë se jemi të drejtë ndaj ndjenjave fetare të nënshtetasve tanë dhe me këtë do të fitojmë plotësisht dhe do të përmbushim pritjet e të gjithëve. Mund ta mbajmë kryqin në flamur, por besoni se më pas do ta humbasim këtë flotë, e cila do të jetë një mjet i pasur i tregtisë sonë dhe do ta përhapë emrin malazez në mbarë botën. Dje kuptova se Turqisë nuk i intereson aq shpërngulja e ulqinakëve, sa shpërngulja e kapitenëve dhe anijeve të tyre, dhe të ndërtojnë një qytet të ri detar në anën tjetër të Bunës në San Gjovani. Flamuri ynë kryqtar do t'i ngrejë, që përndryshe asnjë forcë nuk do t'i ngrinte. Ulqini me anije ka rëndësi të madhe, por pa anije jo. Mos e humbisni për inat të thjeshtë. Nesër do t'ju shkruaj më shumë për këtë, e kam për detyrë t'ju lajmëroj shpejt.

BASHKANGJITJA NR. 5. Ilustrimet



↗ foto
Shqiptari në veshjen
tradicionale



↗ foto
Ulqinakët në Cetinë



↗ foto
Para dyqanit,
Matilda D'Andlau

BASHKANGJITJA NR. 6. Veshja sot



foto
Veshja e burrave
Malësorë



foto
Veshja e grave
shqiptare

BASHKANGJITJA NR. 7. Gramatika shqipe




foto:
Grammaire Albanaise

Monografitë

Batriqeviq, Gjuro, *Zhvillimi i shërbimit muzeor në Mal të Zi*, Cetinë, 1998.

Çilikov, Aleksandar, *Ikonat në Mal të Zi*, Podgoricë, 2014.

Qirkoviq, Sima, Bogdanoviq, Dimitrije, Koraq, Vojislav, Maksimoviq Jovanka, Mijoviq, Pavle, *Histori e Malit të Zi 2, tom 1*, Titograd, 1970.

Gjurishiq, Lilana, Rajkoviq, Tatjana, Markush, Blazho, *Veshjet kombëtare të Malit të Zi të shekujve XIX – X*, Cetinë, 2018.

Franetoviq, kap. Dinko, *Historia e detarisë dhe peshkimit të Malit të Zi deri në vitin 1918*, Titograd, 1960.

Joviqeviq, Mihailo, *Emblemat shtetërore dhe dinastike malazeze*, Cetinë, 2001.

Martinoviq, Jovan, *Mbishkrimi antik në Mal të Zi*, Podgoricë, 2011.

Mijoviq, Pavle, *Thesari artistik i Malit të Zi*, Titograd, 1980.

Punime shkencore dhe artikuj

Borozan, Branislav, *Deklarata e fshehur e gdhendjes nga Oktoih i Cetinës*, Matica nr. 44.

Muhadinoviq, Jovan, *Muzetë e Cetinës*, u: Kuzman, Filip, *Hëna nën Lovqen*, Cetinë, 2023.

Vujadinoviq, Radovan, *E burgosura Hasena Terziq*, Katër korrik – faqja SUBNOR e Jugosllavisë, 27. nëntor 1979.

Artikuj nga enciklopeditë dhe leksikonet

Martinoviq, Niko, redaktor, *Leksiku i artit të Malit të Zi*, CANU, Podgoricë 2022, artikujt:

- Koprivica, Tatjana, *Ston në Peleshac, Kisha e Shën. Mihailit*
- Martinoviq, Niko, *Bukovac, Vlaho*
- Martinoviq, Niko, *Jakshiq, Gjura*
- Martinoviq, Niko, *Jovanoviq, Paja*
- Martinoviq, Niko, *Kikerec, Ferdo*
- Martinoviq, Niko, *Poçek, Pero*
- Zekoviq, Lilana, *Adrovic, Refik*
- Zekoviq, Lilana, *Karailo, Smail Smajo*
- Zekoviq, Lilana, *Milunoviq, Milo*

Gjurgjeviq-Gjukiq, Olga, redaktor, *Heronjtë Kombëtarë të Jugosllavisë*, Instituti për Historinë Bashkëkohore, 1975, artikujt:

- *Asoviq Muja Muharem*
- *Burxheviq[Sic] Nazija Rifat Trsho*

Gazheviq, Nikola, redaktor, *Instituti Botues Ushtarak*, 1971, artikujt:

- Brajushkoviq, Dimitrije, *Brigada e Nëntë malazeze*

Manuale dhe rekomandime në fushën e multikulturalizmit

Quality History Education in the 21st Century – Principles and Guidelines,

Council of Europe, September 2018.

Radulović, Vasilije, *Multikulturalizmi dhe komunitetet e nënpërfaqësuar në sistemin arsimor malazez*, Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ), Podgoricë, 2023.

Vujović, Rade, Vukanović, Milosh, *Pasuria e diversitetit*, Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ), Podgoricë, 2021.

Librat e inventarit

Inventari i Muzeut të Arkivit

Inventari i Muzeut Shtetëror

Inventari i Muzeut Etnografik

Inventari i fotove të LNÇ-së

Inventari i dokumenteve origjinale të muzeut të LNÇ-së

Inventari i Muzeut të Artit

Aktet ligjore dhe nënligjore

Statuti i Institucionit Publik Muzeu Kombëtar i Malit të Zi, Cetinë, 2019.

Ligji i Përgjithshëm për Arsimin dhe Edukim

Ligji për Veprimtarinë Muzeale

Ligji për Kulturën

Miranović, Anastazija, Malbasha, Predrag, Berkuljan, Aleksandar, *Manual - koleksion i rregulloreve themelore dhe të lidhura me veprimtaritë muzeale, arkivore dhe bibliotekare*, Cetinë, 2019.

Katalogë dhe udhëzues

Joviqević, Mihailo, Pejović, Tatjana, Lompar, Mladen, Cetinë 1986.

Rajković, Tatjana, *Bukuria e Diversitetit*, Cetinë, 2023.

Programet lëndore dhe tekstet shkollore

Berilazhiq, Dragan, Shqepanović, Vidoje, Borić, Sanja, *Programi lëndor Arti figurativ*, Podgoricë, 2020.

Gjorgjeviq, Jasmina, Popović, Radovan, Gjokić, Dragoje, *Programi zgjedhor Historia e fesë 1 dhe programi zgjedhor Historia e fesë 2*, Podgoricë, 2009.

Krivokapić, Natasha, Ivanović, Ana, Gjuć, Ivan, *Programi lëndor Sociologjia për klasën e III të gjinzait të përgjithshëm*, Podgoricë, 2020.

Krivokapić, Natasha, Ivanović, Ana, Gjuć, Ivan, *Sociologjia e kulturës për klasën e III të shkollës së mesme të përgjithshme*, Podgoricë, 2020.

Krivokapić, Natasha, Ivanović, Ana, Gjuć, Ivan, *Sociologjia e kulturës për klasën e IV të shkollës së mesme të përgjithshme*, Podgoricë, 2020.

Krkeljić, Tatjana, Janković, Tina, Nikezić, Bojana, *Programi lëndor Arti Muzikor*, Podgoricë, 2020.

Papović, Dragutin, Šabotić, Sait, Shqekić, Milan, *Historia libër për klasën e tretë të shkollës së mesme*, Podgoricë, 2021.

Peroshević, Peroshević, Gjorgjević, Jasmina, Kovačević, Vesna, *Programi lëndor Historia I, II, III dhe IV klasë*, Podgoricë, 2020.

Linqet

<https://narodnimuzej.me/2020/12/23/ikona-bogorodice-filermose/>

